

Shefkije Islamaj, Nexhmije Thaçi–Mehmetaj

GJUHA SHQIPE

Përbledhje e gramatikës shqipe

Fletore tematike
për nivelin e tretë

duk^əgjini

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS

TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË

Autorë/e:
Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,
Nexhmije Thaçi-Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj,
Xhevat Syla.

Hartuese të këtij teksti: Shefkije Islamaj, Nexhmije Thaçi-Mehmetaj

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.



PËRMBAJTJA			
GJUHA SHQIPE	5	FJALIA – PERIUDHA	47
E kaluara, e sotmja, e ardhmja	5	Llojet e fjalive	49
Historia e shqipes së shkruar	7	Fjalia kryesore,	
Dialektet, të folmet dhe gjuha standarde	8	fjalia e pavarur, fjalia e varur	52
		Periudha me fjali	
		të bashkërenditura	54
GRAMATIKA		Periudha me fjali	
E GJUHËS SHQIPE	11	të nënrenditura	56
		Gjymtyrët kryesore të fjalisë	61
MORFOLOGJIA	13	Kryefjala dhe kallëzuesi	58
		Gjymtyrët e dyta të fjalisë	61
LLOJET E FJALËVE	15	Përcaktorët	61
Emri dhe gjinia e emrit	17	Ndajshimi	63
Numri dhe		Kundrinori	64
shquarsia/pashquarsia e emrave	20	Kundrinori i drejtë	65
Lakimi i emrave	22	Kundrinori i zhdrojtë	67
Mbiemri	25	Rrethanori	70
Lakimi i mbiemrave	28		
Numërori	31	LEKSIKOLOGJIA	73
Përemri	32	Fjalëformimi	73
Lakimi i përemrave	35	Leksiku dhe semantika	76
Folja		Sinonimet	78
Kohët e mënyrat	38	Antonimet	80
Mënyra dëftore	39	Fjalësi i gjuhës shqipe dhe	
Mënyra lidhore	41	Fjalët e huaja	83
Ndajfolja	44		
		DREJTHSHKrim	86
		Shkrimi i ë-së së patheksuar	
		në pozita të ndryshme të fjalës	88
		Shkrimi i ë-së në fund të fjalës	88
		Shkrimi i nyjës së përparme	89



Harta e fiseve ilire

GJ U H A SH Q I P E

E kaluara, e sotmja, e ardhmjë

Përsërisim ato që kemi mësuar më herët për historinë e gjuhës shqipe!

Origjina e gjuhëve është vështirë për t'u sqaruar. Për burimin e shqipes ekzistojnë dy teza themelore: ajo e prejardhjes **ilire** dhe ajo e prejardhjes **trake**. Sipas disa dëshmive gjuhësore e arkeologjike të zbuluara nga gjuhëtarët, historianët e arkeologët mendohet se ilirët janë **paraardhësit e shqiptarëve** të sotëm.

Ku mbështetet teza e ilirishtes?

Ja disa prej argumenteve:

- Shqipja flitet në një pjesë të territorit ku është folur në lashtësi ilirishtja;
- Disa elemente gjuhësore që njihen si ilire mund të shpjegohen me anë të shqipes;
- Emërtimet e vendbanimeve antike kur krahasohen me format e tyre të sotme tregojnë se zhvillimet janë në përputhje me fonetikën e morfologjinë shqipe.
- Ilirët, në lashtësi ishin një popullsi e madhe dhe jetonin në Ballkanin Perëndimor, aty ku jetojnë sot shqiptarët.

Ilirët përbëheshin prej fiseve, ndër të cilët më së shumti përmenden **liburnët**, **dalmatët**, **dasaretët**, **molosët**, **labeatët**, **dardanët**, **taulantët** e të tjera.

Harta e fiseve ilire

Shqiptarët sot jetojnë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbinë Juglindore, Greqinë Veriore dhe në diasporë.



Gjuha shqipe është gjuha e shqiptarëve.

Gjuha shqipe është gjuhë indoевropiane.

C'janë gjuhët indoevropiane?

Gjuhët indoevropiane janë një familje gjuhësore që përfshin një numër të madh të gjuhëve të gjalla e të vdekura me shtrirje në të gjitha kontinentet dhe që kanë ngjashmëri dhe bashkëpërkime leksikore, fonetike e gramatikore mes vete. *Shih për këtë drurin gjenealogjik të gjuhëve indoevropiane në faqen 58 të fletores «Gjuha shqipe» për nivelin e dytë!*

Disa nga gjuhët indoevropiane, pos **shqipes**, janë: **greqishtja, latinishtja, gjuhët romane** (frëngjishtja, italishtja, spanjishtja, rumanishtja etj.), **gjuhët gjermanike** (gjermanishtja, danishtja, suedishtje, norvegjishtja etj.), **gjuhët sllave** (rusishtja, serbishtja, kroatishtja, maqedonishtja, polonishtja etj.), **gjuhët kelte** (skocishtja, irlandishtja) etj., **gjuhët iranike** (persishtja, avganishtja etj.).

Gjuhë të vjetra indoevropiane janë: **sanskritishtja** (në Indi), **ilirishtja, trakishtja, latinishtja, greqishtja e vjetër** etj.

Mbani në mend!

Shqipja përbën degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane.

Çka ka trashëguar shqipja prej gjuhëve indoevropiane?

Ajo ka trashëguar **strukturën e ndërtimit** dhe rrëth **dy mijë** fjalë. Disa nga fjalët e trashëgura nga gjuha indoevropiane janë: *ditë, natë, diell, kokë, dimër, ujë, ha, pi, jam, zog, dem, djathë, dorë, drekë, elb, èndërr, mal, emër, kohë, gjarpër, mjegull, mjekër* etj.

HISTORIA E SHQIPES SË SHKRUAR

Gjuha shqipe është dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV. Dokumentet e para shkrimore të shqipes janë: «Formula e Pagëzimit» (1462), «Fjalorthi i Arnold Von Harfit» (1496) dhe «Perikopeja e Ungjillit» (XV).


Më 1555 u botua libri i parë shqip «Meshari i Gjon Buzukut». «Meshari» është një libër fetar i lutjeve dhe ka rëndësi historike e gjuhësore. Libri i dytë është «E mbësuame e krështerë» e **Lekë Matrangës**, botuar më 1592. «Meshari» është i shkruar në gegërishte, kurse e «E mbësuame e krështerë» në toskërishte.

Një autor tjetër shqiptar i shekullit XVI është historiani i parë shqiptar **Marin Barleti** i cili ka shkruar në gjuhën latine «Historinë e jetës dhe të veprës së Skënderbeut» (1508-1510). Autorë të tjerë të librave shqip që kanë shkruar që në shek. XVII janë **Pjetër Budi**, **Pjetër Bogdani** dhe **Frang Bardhi**, i cili është autor i fjalorit të parë shqip me titullin «Fjalori latinisht-shqip» (1635).

Shekulli XIX njihet si shekulli i zhvillimit shumë të madh të gjuhës, të letërsisë e të kulturës shqiptare. Kjo periudhë quhet **Rilindja Kombëtare Shqiptare**. Përfaqësuesit më të mëdhenj të kësaj periudhe janë: Jeronim de Rada, Naum Veçilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Zef Serembe e të tjerë.

Mbani në mend !

Ka mjaft të dhëna që na tregojnë se edhe para këtyre shkrimeve është shkruar në gjuhën shqipe, por ende nuk janë gjetur dëshmi të sigurta.



DIALEKTET, TË FOLMET DHE GJUHA STANDARDE

Gjuha shqipe, sikur gjuhët e tjera, ka dialekte e të folme.

Përsërisim

Dialekti është varianti a lloji i një gjuhe që flitet nga një bashkësi a nga një grup njerëzish që banojnë në një territor më të gjerë a më të kufizuar.

E folmja është variant gjuhësor që flitet në një territor shumë më të ngushtë, është ndarje nëndialektore, sikur fjala vjen e folmja e Prizrenit, të folmet e arbëreshëve, e folmja e Çamërisë etj.

Mbani mend!

Gjuha shqipe ka dy dialekte dhe ato janë: **gegërishtja** dhe **toskërishtja**.

Gegërishtja flitet në Shqipërinë e Veriut dhe në atë të Mesme, në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore, në Serbinë Juglindore dhe në Malin e Zi.

Toskërishtja flitet në Shqipërinë e Jugut, në Çamëri e në diasporën shqiptare në Itali, Greqi, Bullgari e në Ukrainë.

Dy dialektet e shqipes i ndan lumi Shkumbin. Të dyja dialektet kanë nëndialekte e shumë të folme. Dallimet midis dialekteve të shqipes nuk janë të mëdha. Shqiptarët kudo janë kuptohen mes vete.

Dallimet midis dialekteve vërehen në sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore e shumë më pak në leksik.

T'i shohim dallimet kryesore!

- Në **fonetikë**, gegërishtja ka zanore hundore: **nâna, kânga, âmbël, âsht, râna, ândrra, zâni**, kurse në dialektin e Jugut këto zanore na dalin me **ë**: nëna, kënga, ëmbël, është, rëra, ëndrra, zëri.
- Në **gegërishte**, togu **ua** i toskërishtes del me **ue**: **grua/grue, përrua/prrue, thuaj/ thuej, mua / mue** etj.
- Në **toskërishte** fjalët me **-n** midis dy zanoreve dalin me **-r**: **bëra/bâna, dimër/dimën, lakra/lakna, hyri/hyni, fëmijëri/fëmijëni** etj.
- Në **morfologji** vërejmë dallimin e shumësit të emrave: **nxënës/ nxânësa, puse/ pusa, mollë/ molla, brirë;brina, shtëpi/shtëpija** etj.
- Në **leksik** dallimet janë më të vogla. Mbi 90% e leksikut të shqipes është i përbashkët për të dyja dialekta. Disa fjalë përdoren vetëm në gegërishten ose vetëm në toskërishten: **tambël/qumësh, tlyn/gjalpë, çikë/vajzë, komshi/kojshi** etj.

Lexoni me kujdes në faqen vijuese poezitë e dy shkrimtarëve tanë të njojur të cilët kanë shkruar në dialektet e tyre dhe përgjigjeni pyetjeve që vijojnë:

1. A i keni kuptuar tekstet që i lexuat? Çka ju dukej e vështirë?
2. Si dhe përse mund të dalloni cili është dialekti gegë e cili dialekti toskë?
3. Gjej dhe përshkruaj disa dallime e ngashmëri gjuhësore në të dy dialektek!
4. Cili dialekt është më afër gjuhës standarde? Trego pse!
5. A kanë dialekta gjuhët e vendit ku jetoni ju? Si dallohen ato nga gjuhës standarde?

Gegërisht	Toskërisht
<p>Migjeni</p> <p>KANGA E RINISË</p> <p>Rini, thueja kangës ma të bukur që di! Thueja kangës sate që të vlon në gjë. Nxirre gëzimin tand' të shpërthejë me vrull... Mos e freno kangën! Le të marri udhë.</p> <p>Thueja kangës, rini, pash syt e tu... Të rrroki, të puthi kanga, të nxisi me dashnu me zjarrm tand, rini... Dhe të na mbysi dallga prej ndjenjash të shkumbzueme q'i turbullon kanga.</p>	<p>Fan Noli</p> <p>ANËS LUMENJVE</p> <p>Arratisur, syrgjynosur, Rraskapitur dhe katosur Po vajtonj pa funt, pa shpresë, Anës Elbë-s, anës Spree-së. Ku e lam' e ku na mbeti, Vaj-vatani e mjer mileti, Anës detit i palarë, Anës dritës i paparë, Pranë sofrës i pangrënë, Pranë dijes i panxënë, Lakuriq dhe i dregosur, Trup e shpirt i sakatosur. ...</p>

Gjuha standarde shqipe

Deri në vitin 1972 shqiptarët kanë shkruar në dialekta. Në vitin 1972 në Tiranë u mblohdhën studiuesit e gjuhës shqipe nga të gjitha trojet shqiptare dhe mbajtën **Kongresin e Drejtshkrimit**. Në Kongres u miratuan rregullat e drejtshkrimit që zbatojmë sot kur flasim e shkruajmë.

Që nga ajo kohë shqiptarët kanë një gjuhë të përbashkët shqipe. Formimi i gjuhës standarde shqipe ka përshkuar rrugë të gjatë shekujsh XV-XX. Ajo është krijuar me marrëveshje mbi bazën e dialektit toskë, por përmban edhe shume elemente të gegërishtes.

Mbani në mend!

Gjuha standarde është variant i përpunuar dhe i kodifikuar i gjuhës shqipe. Gjuha standarde nuk është gjuhë dialektore. Gjuha standarde është gjuha e përbashkët e shqiptarëve.

Gjuha standarde është gjuha e shkollës, gjuha e librave, e televizionit dhe gjuha e dokumenteve zyrtare.

Tashmë e dimë se:

Gjuha standarde duhet të mësohet, sepse ajo është gjuha e përbashkët e gjithë shqiptarëve dhe gjuha në të cilën shkruhet shqip. Gjuhën standarde e mësojmë në shkollë, ndërsa për ta mësuar na ndihmojnë edhe **gramatika**, **drejtshkrimi** dhe **fjalori**.



GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE

Të mësosh gjuhën standarde shqipe dhe gramatikën e saj nuk është lehtë. Nga lindja ju keni mësuar të flisni nga prindërit dhe të tjerët në familjet tuaja. Gjuha që mësoni nga lindja e derisa të shkoni në shkollë është gjuha amtare. Gjuha amtare mund të jetë dialekti gegë ose dialekti toskë. Por, në ditën që uleni në bankat e shkollës shqipe, ju njiheni me gjuhën standarde shqipe, që është pak a shumë më ndryshe nga ajo që e keni mësuar dhe keni folur deri atëherë.

Përsërisim njohuritë tonë!

Gjuha amtare është gjuha që mësojmë nga lindja, është gjuha e prindërve dhe e familjarëve tanë.


Gjuha standarde është gjuha e shkollës, gjuha e librave, e televizionit dhe gjuha e dokumenteve zyrtare.

Që nga librat e gjuhës për nivelin e parë e të dytin dimë ç'është **tingulli, rrokja, fjala, fjalia**, dimë ç'është **emri, mbiemri, folja** e llojet e tjera të fjalëve, dimë ç'është **kryefjala, kallëzuesi, rr Ethanori, fjalia, llojet e fjalive**. Dimë edhe shumëçka tjetër. Por, ta mësosh gramatikën e gjuhës duhet mjaft mund e zell.

Po nisim me gramatikën. Ç'është gramatika?

Gramatika është tërësia e rregullave të një gjuhe – si ndryshojnë format e fjalëve të një gjuhe dhe si lidhen ato në fjali.

Gramatika na mëson për tingujt dhe ndarjen e tyre, për llojet e fjalëve, për fjalinë e pjesët përbërëse të saj, për llojet e fjalive etj.



Çdo gjuhë ka gramatikën e vet.

Ai që studion gramatikën e një gjuhe quhet **gramatikan**.

Gramatika ka rregulla.

Ç'janë rregullat gramatikore?

Rregullat gramatikore na tregojnë nëse kemi folur ose kemi shkruar drejt.

Fjala vjen, nëse kemi shkruar «Unë ecim nëpër bar» në vend të «Unë eci nëpër bar» ose nëse kemi shkruar emrat e njerëzve me shkronjë të vogël («e dua arbenin») atëherë themi se kemi shkelur rregullat gramatikore.

Rregullat gramatikore përshkruhen në tekstet gramatikore.

Mbani në mend!

Gjuha mund të konsiderohet sistem – sistem, i cili e rregullon komunikimin tanë me gojë ose me shkrim në fusha të ndryshme.

Si çdo sistem, edhe gjuha e ka strukturën e vet, të cilën mund ta shihni këtu:

Struktura e gjuhës

shqiptimi

gramatika

kuptimi

fonetika

morfologja

semantika

sintaksa

Bisedojmë!

Të shohim ç'keni mbajtur në mend nga ajo që mësuat sot e që njihni prej viteve të shkuara!

1. Ç'është shqiptimi? A e dini ç'është fonetika?

Shqiptim do të thotë _____

Fonetika përshkruan _____

2. Ç'është kuptimi? A e dini ç'është semantika?

Kuptim do të thotë _____

Semantika përshkruan _____

3. Ç'është fjala? Po morfologja?

Fjala është _____

Morfologja përshkruan _____

4. Ç'është fjalia? A e dini ç'është sintaksa?

Fjalia është _____

Sintaksa përshkruan _____

M O R F O L O G J I A

Duhet të dini se:

- Morfologjia është pjesë e gramatikës që përshkruan **format e fjalëve, llojet e fjalëve** dhe **mënyrat e formimit të fjalëve**.
- Ndryshimi i formës së fjalës varet nga **funkioni** i saj në fjalë.

Fjala, siç e kemi mësuar më herët, është **njësia themelore e gjuhës që ka kuptim dhe formë**: *njeri, libër, mësoj, pardje, qiellor, kompjuter, lojë, trimëri*.

Ajo mund të ndahet në njësi më të vogla. Njësia më e vogël e fjalës quhet **morfemë**. Morfema ka kuptim, por nuk është njësi e pavarur siç është fjala.

Pra, fjala ndahet në morfema, si p.sh.: **qiell-or, trim-ëri, par-dje**, kurse morfema ndahet vetëm në tinguj: **qiell – q-i-e-ll**.

Fjalët **qiellor, trimëri** dhe **pardje** kanë nga dy morfema: **qiell + or; trim + ëri; par + dje**.

Morfemat formësojnë kuptimisht fjalën:

lex-oj	lex-on
ri-lex-oj	lex-ojmë
lex-im	lex-uar

Ushtrojmë!

Ndani më morfema pjesët përbërëse të fjalëve në vijim:

fshatar	fshat –ar	përzgjedh
vajzave	arsyetoj
zviceran	skijojmë
përpunoj	furrtar
besnik	shqiptar

Mbani në mend!

Një numër fjalësh përbëhen vetëm prej një morfeme.

Po kështu duhet të dini se:

- Fjalët kanë kuptime dhe veçori gramatikore të ndryshme:
 - Disa fjalë emërtojnë **frymori**, sende e dukuri (**njeri, fëmijë, grua, gjel, tigër, çantë, mal, qiell**, etj.). Këto fjalë quhen **emra**.
 - Disa fjalë emërtojnë **veprime** (**flas, eci, fryn, punojmë, flenë, lexoj, qep, vozis** etj.). Këto fjalë quhen **folje**.
 - Disa fjalë emërtojnë **cilësi** (**i mirë, i bardhë, i gjerë, i lumtur, frikacak, i mençur, i prishur, i shtrembër, metalik, trim, i ndjeshëm** etj.). Këto fjalë quhen **mbiemra**.
 - Disa fjalë tregojnë mënyrë, kohë, sasi, vend (**keq, lart, pak, rrëmbyeshëm, papritur, gëzueshëm, djathtas, tmerrësish** etj.). Këto fjalë quhen **ndajfolje**.
 - Disa fjalë tregojnë **sasi, radhë** (**një, pesë, i treti, e parë, dyzet** etj.). Këto fjalë quhen **numërorë**.
 - Disa fjalë shërbejnë për të lidhur fjalët në fjali ose fjalitë në tekstin. Këto fjalë janë disa llojesh dhe njihen me emrat **parafjalë** (**për, me, nga, rreth, prej**, etj.), **lidhëza** (e, dhe, edhe, megjithëse, sikur, kur, etj.), **pjesëza** (**po, nuk, s', ja, bash, pothuajse** etj.). Një grup i veçantë janë **pasthirrmat** (**ua, bobo, shëët, qyqja, ah** etj.).

Mësojmë!

Llojet e fjalëve kategorizohen sipas tri kritereve: **semantik, morfologjik** dhe **sintaksor**.

- Sipas kriterit **semantik** emri emërton **njerëz, kafshë, sende, vende, dukuri** etj.
- Sipas kriterit morfologjik **emri** dallohet me kategoritë morfologjike: **gjini, numër, rasë, shquarsi**.
- Sipas kriterit **sintaksor** emri në fjali kryen funksionin e **kryefjalës, të subjektit, të objektit** etj.

Edhe llojet e tjera të fjalëve, sikur emri, kategorizohen sipas **këtyre kritereve**.

Detyrë

Përcaktoni llojin e këtyre fjalëve:

vajzë- emër	i bardhë-_____	dje-_____	edhe-_____
vrapoj-_____	para-_____	ata-_____	i dyti-_____
uaa-_____	me-_____	dimri-_____	frikacak-_____
dyzet e pesë-_____	prej-_____	pikërisht-_____	erdhëm-_____
telefon-_____	gatuaj-_____	unë-_____	porsi-_____

LL O J E T E F J A L Ë V E

Mbani në mend!

Të gjitha fjalët e një gjuhe quhen **pjesë të ligjëratisë**. Gjuha shqipe ka këto pjesë të ligjëratisë: **emri, mbiemri, përemri, numërori, folja, ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza, pasthirma**. Nga këto pjesë të ligjëratisë, pesë të parat gjatë përdorimit të tyre ndërrojnë formën, prandaj quhen **fjalë të ndryshueshme**, kurse pesë të tjerat nuk ndërrojnë format e tyre gjatë përdorimit, prandaj quhen **fjalë të pandryshueshme**.

Fjalët e ndryshueshme

emri	ndajfolja
mbiemri	parafjala
përemri	lidhëza
folja	pjesëza
numërori	pasthirma

Fjalët e ndryshueshme kanë kategorinë e gjinisë, të numrit, të rasës, të mënyrës, të kohës e të tjera.

Lloji i fjalëve

Lloji i fjalëve	Kategoria
emri	gjini, numër, shquarsi, rasë
mbiemri	gjini, numër, rasë, shkallë krahasimi
përemri	gjini, numër, rasë, vetë
folja	gjini, numër, vetë, mënyrë, kohë
numërori	gjini, rasë

Bisedojmë!

Si i quajnë llojet e fjalëve në gjuhën e vendit ku jeton ti dhe (nëse e di) në anglisht?

Shqip

Në gjuhën e vendit ku jeton ti

Anglisht

Emri

.....

Noun

Mbiemri

.....

.....

Përemri

.....

.....

Folja

.....

.....

Numërori
Ndajfolja
Parafjala
Lidhëza
Pjesëza
Pasthirrma

Lexojmë tekstin në vijim bashkërisht dhe përdallojmë fjalët sipas llojit:

Dhelpra dhe rrushi

Një ditë të nxeh të vere dhelpra kishte dalë në një bahçë me fruta. Ajo pa bistak rrushi të pjekur mirë në një hardhi dhe tha më vete:

- Ah këto frutat që do të mund të më shuajnë etjen.

Dhe goja nisi t'i lëshojë lëng. Pastaj u vërsul drejt pemës, por nuk arriti bistakët. Provoi sërisht por nuk ia arriti...

La Fonteni

një - numëror	ditë -	të nxeh të -
vere -	dhelpra -	kishte dalë -
në -	një -	bahçë -
me -	fruta -	ajo -
pa -	bistak -	rrush -
të pjekur -	mirë -	në -
hardhi -	dhe -	tha -
me -	vete -	ah -
këto -	që -	pastaj -
drejt -	por -	nuk -

EMRI DHE GJINIA E EMRIT

A e keni mbajtur në mend se çka quajmë emër? Po rikujtojmë.

Fjala që emërton një frymor, një send, një cilësi, një veprim quhet **emër**.

Kategoritë gramatikore të emrit janë: **gjinia, numri, shquarsia** dhe **rasa**.

A e dini se:

- emrat në fjali janë fjalë të pavarura dhe mund të kryejnë të gjitha funksionet e fjalëve, si kryefjalë, si kundrinë, si ndajshtim etj. Edhe këto do t'i mësojmë në vijim.
- emrat sipas kuptimit klasifikohen në: **emra të përveçëm** dhe **emra të përgjithshëm**.

1. Emrat e përveçëm:

- **emra njerëzish** dhe **pseudonime**: *Bardhyl, Teutë, Dritë, Laurë, Gjin, Tom*
- **emra kafshësh**: *Reks, Balosh, Murrojë, Bubi, Murro*
- **emra vendesh, shtetesh, qytetesh, malesh, fushash, detesh, lumenjsh**:
Shqipëri, Evropë, Gjermani, Bern, Prishtinë, Adriatik, Korab, Shkumbin, liqeni i Prespës
- **emra të trupave qiellorë**: *Dielli, Hëna, Jupiteri, Kashta e Kumtrit, Ylli Polar, Toka*
- **emra të ngjarjeve dhe periudhave historike**: *Rilindja Kombëtare, Kongresi i Manastirit, Luftërat e Skënderbeut, Lufta e UÇk-së*
- **titujt e veprave letrare, të gazetave e të revistave**: "Lulet e verës", "Lahuta e Malcis", "Lumi i vdekur", "Hari Poteri", "Iliada", "Top channel"

2. Emra të përgjithshëm:

genie, objekte, dukuri: *vajzë, libër, yll, papagall, dorë, erë, art, film, internet, pikturë, makinë, brushë*.

Emrat e përgjithshëm ndahen në: **emra konkretë** që shënojnë frymorë, sende dhe dukuri që mund të numërohen ose të preken: *vogëlush, shishe, laps, dele, ujë, fustan*, etj. dhe në **emra abstraktë** që shënojnë gjendje, cilësi e veprime: *mendim, ndjenjë, trimëri, rrënë, pikëllim, butësi* etj.

Mbani në mend!

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjën e parë të madhe.

E thamë më lart se emrat kanë **kategorinë e gjinisë**. Emri në gjuhën shqipe ka **tri gjini**:

- 1. **mashkullore**: njeri, flamur, bar, det, libër, këngëtar, laptop, rok, mendim, shtrat etj.
- 2. **femërore**: fytyrë, sofër, fëmijë, ëndërr, xhevze, zemër, patinazh, bukuri, gotë, etj.
- 3. **asnjanëse**: të lozurit, të vrapuarit, të lexuarit, të uruarit, të ngrënët, etj.

Mbani në mend!

1. Një emër duhet të përdoret **gjithmonë** në gjininë e vet: **ajo** vajzë, **ky** djalë, **këta** lepuj, **këto** fjalë.

2. Një **grup emrash përdoren** në të dyja gjinitë – prandaj quhen **emra të dygjinishëm**. Kështu një numër emrash të gjinisë mashkullore në shumës kalojnë në gjininë femërore: (ky) mal – (këto) male, (ky) det - (këto) dete, (ky) aeroport - (këto) aeroporte, (ky) atllas – (këto) atllase, (ky) çift - (këto) çifte, (ky) ballkon - (këto) ballkone, (ky) bacil – (këto) bacile etj.

3. **Ndërrimi i gjinisë te këta emra vërehet sidomos kur këta emra shoqërohen me **mbiemra****: një aeroport i madh **mirëpo** aeroporte të mëdha, një det i gjerë **mirëpo** dete të gjera, një mendim i qartë **mirëpo** mendime të qarta, ujë i kthjellët **mirëpo** ujëra të kthjellta etj.

Vërejtje! Emri **libër** i gjinisë mashkullore edhe në shumës e ruan këtë gjini, pra: (ky) libër – (këta) **libra** dhe **librat e rinj** e jo **librat e reja**!

Ushtrojmë!

Emrat e mëposhtëm kthejni në shumës dhe shoqëroji me mbiemrat përkatës në aspektin kuptimor dhe gramatikor: **i ri**, **i bukur**, **i gjerë**, **i bardhë**, **i madh**, **i gjelbër**, **i lartë**, **luksoz**.

botim - **botime të reja**

raft - _____

sallon - _____

fustan - _____

inat - _____

breg - _____

ekip - _____

hotel - _____

Detyrë:

Përdalloji emrat e dygjinishëm në tekstin në vijim dhe shënoji ata në fletoren tënde!

VDEKJA E SKËNDERBEUT

Zemërimi i Sulltanit kundër shqiptarëve dhe venecianëve ishte aq i madh, sa në mes të dimrit, një turmë prej 15000 turqish, përmes **maleve** të mbuluara me dëborë, u duk përpara Shkodrës. Kur erdhi lajmi në Lezhë, kryetrimi i sëmurë në shtrat të vdekjes u përpoq të ngrihej e të kapte armët dhe dha urdhër që t'i gatitnin kalin. ... Po tmerri i emrit të tij ishte aq i madh, sa turqit me të parë “kohorten pretoriane”, kujtuan se ishte dhe ai, morën arratinë dhe u shuan krejt prej malësoreve nëpër gryka dhe pusi. Skënderbeu mezi merrte fryme, kur i sollëm lajmin e mirë të fitores së fundme. Kur i thanë mjekët se s’kishte me asnje shpresë për shërim, thirri princërit shqiptarë dhe bajlozët e Venetisë, të cilëve u la shëndet dhe i këshilloi të vazhdojnë luftën e përbashkët kundër turqve. Mbretërinë e tij ja la të birit, Gjon Kastriotit, me mbretëreshën si regjente, dhe i porositi që, po të ndodheshin në rrezik, të shkonin në qytetet që i kishte falur Ferdinandi i Napolit.

Mund të marrim me mend hidhërimin që ndjeu Skënderbeu, kur hodhi rreth tij syrin e mjegulluar nga hija e vdekjes dhe s’pa asnjë princ shqiptar të zotin për të pasuruar veprën, të cilën vdekja s’ë la ta mbaronte.

Fan Noli «Historia e Skënderbeut»



NUMRI DHE SHQUARSIA/PASHQUARSIA E EMRAVE

Përsërisim ato që kemi mësuar më parë!

Gjuha shqipe njeh dy numra: **njëjës** dhe **shumës**.

Emrat e gjuhës shqipe e formojnë shumësin në njëren nga këto katër mënyra kryesore:

1. me mbaresa të ndryshme: (një) mur – (shumë) mure, (një) grusht – (shumë) grushte, (një) libër – (disa) libra, (një) fshat – (shumë) fshatra, (një) shkumës – katër shkumësa, një gocë – shumë goca etj.

2. me ndryshime fonetike të ndonjë tingulli të temës: (një) breg – (shumë) brigje, (një) dorë – (shumë) duar, (një) derë – (shumë) dyer, një plak – (shumë) pleq, (një) shekull – (shumë) shekuj etj.

3. me mbaresa dhe me ndryshime fonetike: (një) pyll- (shumë) pyje, (një) yll – (shumë) yje, (një) portokall – (shumë) portokaj, (një) kungull – (shumë) kunguj, (një) popull – (shumë) popuj, (një) truall – (shumë) troje, (një) fill – (shumë) fije, (një) fik – (shumë) fiq, (një) oxhak – (shumë) oxhaqe etj.

4. pa ndryshim të trajtës së shumësit: (një) mollë – (shumë) mollë, (një) mësues – (shumë) mësues, (një) mësuese – (shumë) mësuese, (një) fletore – (shumë) fletore, (një) lule – (shumë) lule etj.

Ushtrojmë! Kthejini emrat në njëjës në shumës dhe anasjelltas.

Numri njëjës	Numri shumës
lajthi	studentë
prind	djem
njeri	papagaj
dokument	gjyshër
vëlla	ujëra
shteg	gjarpërinj
shkop	kuaç
princ	etër
batanije	

Mbani në mend!

Në gjuhën shqipe ekziston edhe një grup emrash që përdoren **vetëm në njëjës**:

- **emra abstraktë**: ftohtësi, dashuri, varfëri, nxehësi, trimëri etj.
- **emra përbledhës**: djemuri, vëllazëri, rini etj
- **emra lëndorë**: djathë, gjalpë, cimento, kosë, rërë, vaj etj.
- **emra sëmundjesh**: kollë, rubeolë, fruth, li, angjinë etj.
- **emra dukurish atmosferike, drejtimesh në horizont** etj.: verë, breshër, acar, borë, vesë, pranverë, veri, jug, lindje, perëndim, grurë, misër etj.

Mbani në mend!

Emri ka kategorinë e **shquarsisë** dhe **të pashquarsisë**

Emrat në gjuhën shqipe kanë **kategorinë e shquarsisë** dhe **të pashquarsisë**, pra emri ka **trajtën e pashquar** që është trajta bazë e emrave - *njeri, fletore, rrugë* dhe **trajtën e shquar** - *njeriu, fletorja, rruga*. Emri është në trajtën e shquar kur emri i përgjithshëm tregon diçka të veçantë: frymor, send, dukuri, pra kur merr kuptimin të individualizuar, kurse në rastet kur emri merr para një përemër dëftor (**ky/kjo** ose **këta/këto**) kthehet në **trajtën e pashquar**: *ky njeri, kjo fletore, këta njerëz, këto fletore*.

Të shohim dy shembuj:

Atë **vajzë** e pashë në rrugën përballë. E pashë **vajzën** në rrugën përballë.

Mbani në mend!

1. Emri përdoret në **trajtën e shquar** në rastet kur ai përmendet për të dytën herë në të njëjtin tekst, kur tashmë kemi njoħuri pér atë frymor, send a dukuri pér të cilën flitet a shkruhet. Pér shembull:

Në shtëpinë tonë dje erdhi një vajzë e bukur. Vajza ishte shtatulët e me sy të zinj.

2. Emri përdoret në **trajtën e pashquar** me kuptimin e tij më të përgjithshëm ose me kuptimin e tij të papercaktuar. Pér shembull:

Në shtëpinë tonë dje erdhi një vajzë e bukur. Vajza ishte shtatulët e me sy të zinj.

Trajtën e pashquar të emrave në shumës e gjejmë edhe kur para tyre vendosim ndajfoljet e sasisë: **një, shumë, disa...**

Ushtrojmë!

Në tekstin në vijim përcaktoni se në cilat trajta janë emrat e ngjyrosur me të kuqe dhe pastaj i shënoni ata në fletoret tuaja.

Roja i udhëzoi se nga duhet të shkonin.

-Vazhdoni **rrugën** drejt **perëndimit**, atje ku perëndon **dielli**. Por kini **kujdes**.

Sapo **shtriga** ta kuptojë se ju keni shkelur në **tokën** e saj, do t'ju bëjë **skllevërit** e saj.

Shtriga e Ligë e Perëndimit kishte vetëm një **sy**, por ai ishte si një **dylbi** e fuqishme që vështronte shumë larg.

L.F. Baum, «Magjistari i Ozit»

LAKIMI I EMRAVE

Po rikujtojmë ato që kemi mësuar në Librin e Gjuhës pér nivelin e dytë:

Emri ndryshon kur lidhet me fjalë të tjera në fjali. Ndryshimi që pëson emri kur përdoret në fjali quhet **lakim**. Format e ndryshme që merr emri në fjali quhen **rasa**.

Rasat në gjuhën shqipe janë: **emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore**. Për të gjetur rasat përdorim pyetjet: **kush, i kujt, kujt, kë, prej kujt**.

Shkruaj djathtas emrat e rasave në gjuhën e vendit ku jeton ti!

Emërore – fëmija (kush)

Gjinore – (i, e) fëmijës (i, e,) kujt

Dhanore – fëmijës (kujt)

Kallëzore –fëmijën (kë)

Rrjedhore – prej fëmijës (prej kujt) (.....)

Të shohim si ndërron emri «fëmija» formën në fjali të ndryshme!

1. **Fëmija** i saj qante gjithë kohën.
2. Sytë **e fëmijës** ishin të gjelbër e të mençur.
3. E ëma i dha **fëmijës** një sheqerkë mjalti.
4. Nga oborri mezi dallova **fëmijën** që po bredhte prej një ane në tjetrën.
5. Blerta mori **prej fëmijës** krejt ç'kishte në çantën e vogël.

Shembujt tregojnë se emri në këto pesë fjali ka ndërruar po aq herë formën dhe funksionin sintaksor – një herë paraqitet si kryefjalë, herën tjetër përcaktor, në fjalinë e tretë kundrinë e kështu me radhë.

Ushtrojmë!

1. Më poshtë kemi dhënë katër emra të të dyja gjinive në njëjës dhe shumës, ndërsa ti duhet të vazhdosh lakimin e filluar.

Emërore	kompjuter	nënë	malet	fletoret
Gjinore	_____	_____	_____	_____
Dhanore	_____	_____	_____	_____
Kallëzore	_____	_____	_____	_____
Rrjedhore	_____	_____	_____	_____

2. Lidh me shigjetë rasën me emrin!

- | | |
|-----------|----------------|
| Emërore | • këngës |
| Gjinore | • prej këngës |
| Dhanore | • (i/e) këngës |
| Kallëzore | • kënga |
| Rrjedhore | • këngën |

Mbani në mend!

Edhe lakimi i emrave është dy llojesh: **i pashquar** dhe **i shquar**. Prandaj çdo rasë ka këto dy trajta.

3. Plotëso vendet e zbrazëta me emrat në rasën përkatëse

Numri njëjës, emri i gjinisë mashkulllore

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(një) plak	plaku
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

Numri shumës, emri i gjinisë mashkulllore

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(disa) pleq	pleqtë
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

Numri njëjës, emri i gjinisë femërlore

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(një) shegë	shega
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

Numri shumës, emri i gjinisë femërore

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(disa) shega	shegat
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

Duhet ta dimë se me pyetjet kush?, i/e kujt?, prej kujt? – pyesim vetëm për njerëzit, ndërsa me pyetjet **cili?, cilit?, prej cilit?** – pyesim për njerëzit, për kafshët dhe për sendet. Me pyetjen ç? – pyesim vetëm për kafshët e sendet.

Detyrë shtëpie: Lakoni emrat **qiell e tokë**, në të dy trajtat, në njëjës e shumës!

MBIEMRI

A e keni mbajtur në mend se:

- mbiemrat janë fjalë të ndryshueshme që emërtojnë **cilësi** ose **tipare të frymoriëve**, të sendeve ose **të dukurive**.
- mbiemri zakonisht shoqëron emrin. Ai i përshtatet emrit në **gjini**, në **numër** e në **rasë**; domethënë e merr gjininë, numrin e rasën e emrit që e shoqëron: quell **i kaltër**, vajzë e **vyeshme**, qen **i vogël**, këngë **solemne**, dimër **i gjatë** etj.

Duhet ta dimë!

Mbiemrat përshtatën me emrat në gjini, numër dhe rasë. Pra, mbiemrat kanë kategorinë e **gjinisë**, të **numrit** dhe të **rasës**.

Mbiemrat nuk mund të qëndrojnë në fjali si fjalë të pavarura. Ata në fjali kryejnë funksionin e **cilësorit** dhe të përcaktorit.

Lexoni këto tekste!

Edhe çudi: mëngjesi s'ishte **i keq. E rrallë** dhe **e verdhë**, vërtet, fleta e plepit, përtej dritat e hekura e kafazë, po qelli **i kulluar, i ëmbël...** Gojën e kish **të hidhur**, sikur të kishte ngrënë shafran, quellëzën **të thatë**, gjuhën **të trashë** si shuall bualli...

Mitrush Kuteli "Vjeshta e Xheladin beut"

Nga kreshta **e lartë** e Tomorit u derdhën mbi lëndinat e Myzeqesë rrezet **e vakëta** të diellit **vjeshtuk**... Plakosur nën këtë tis **hiros** e plot athëtimë, mezi po hapte sytë atë ditë **të re** fshati **i vogël**.

Jakov Xoxa «Lumi i vdekur»

Çka keni vërejtur?

Mbiemrat e shkruara me të kuqe në tekstet e mësipërme kanë nyjet – **i, e, të** dhe quhen **mbiemra të nyjshëm**, ndërsa ata me të gjelbër nuk kanë nyja dhe quhen **mbiemra të panyjshëm**:

Pra, mbiemrat ndahen në dy lloje: **të nyjshëm** e **të panyjshëm**:

1. Mbiemra të nyjshëm janë ata që kanë nyjë të përparme: **i, e, të: e madhe, i vetmuar, e hollë, i zymtë, të heshtur.**

2. Mbiemra të panyjshëm janë ata që nuk marrin nyjë të përparme: **katror, mençurake, trimosh, koprrac, thinjak, xheloz.**

Duhet ta dimë!

Mbiemrat sipas kuptimit klasifikohen në dy grupe:

1. **Mbiemra cilësorë**, që tregojnë cilësi: (flokë) **të dredhur**, (fjalë) **e rëndë**, (kulm) **i prishur** etj.
2. **Mbiemra marrëdhëniorë**, që tregojnë marrëdhënie: (dashuri) **prindërore**, (rreze) **diellore**, (dolla) **i hekurt** etj.

Ushtrojmë!

1. Lexo tekstin në vijim dhe ngjyros me ngjyra të ndryshme mbiemrat cilësorë dhe ata marrëdhëniorë.

Binte një shi me pika **të rralla**, që dukej sikur buzëqeshte më vete. Porta e drunjtë u hap dhe në rrugë doli Kako Pinua. E imët, e veshur krejt me të zeza, me çantën e kuqe të veglave nën sqetull, u nis me hapa të lehta për rrugë... Duart e saj të thata, duke nxjerrë nga çanta gjithfarë pincash, telash, penjsh, kutish, i mbushnin fytyrat e nuseve me pikëzime yjesh, degë selvijash, shenja qjellorre, që notonin të gjitha në misterin e bardhë të pudrës... Prapa portave të mbërthyera me pllaka metalike ishin nuset e bukura.

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

2. Lidh emrin me mbiemrin përkatës sipas gjinisë.

vazo	• i kthjellët
mustaqe	• e shijshme
qiell	• sypatrembur
erë	• e ëmbël
këpucë	• të zeza
luan	• e bukur
ëmbëlsirë	• zemërmadhe

Mbani në mend!

Mbiemrat gjatë përdorimit nuk shprehin cilësi në shkallë të njëjtë.

Mbiemri ka kategorinë e **shkallës**. Mbiemri në gjuhën shqipe ka tri shkallë: **pohore, krahasore, sipërore**. (A di ti si quhen ato shkallë në gjuhën e vendit ku jeton ti?)

Të shohim shembujt:

i dijshëm më i dijshëm shumë i dijshëm/më i dijshmi

i lartë më i lartë shumë i lartë/më i larti

i lodhur më i lodhur shumë i lodhur/më i lodhuri

Shkalla pohore e mbiemrit tregon një cilësi të një frysori, të një sendi a të një dukurie.

Shkalla krahasore e mbiemrit tregon një cilësi të një frysori, të një sendi a të një dukurie duke e krahasuar me një tjetër.

Shkalla sipërore e mbiemrit tregon një cilësi të një frysori, të një sendi a të një dukurie në shkallë shumë të lartë ose më të lartën. Kjo shkallë formohet duke i paravënë shkallës pohore pjesëzën **më:** **më + i miri, më + e thella** etj. ose **ndajfoljet:** **shumë, tepër, jashtëzakonisht, fort,** etj.: **shumë** më i shpejtë, **tepër** më i shpejtë, etj.

Detyrë

1. Si quhet shkallëzimi në gjuhën e vendit ku jeton dhe si funksionon? **Krahaso!**

2. Harto një tekst prej dhjetë fjalish ku do të përdorësh mbiemrat: **i gjatë, pranveror, e shpejtë, më shkëlqyes, të mëdhenj, i vjetër, e verdhë, trashamane, shumë i largët, i myllur.**

LAKIMI I MBIEMRAVE

Duhet ta dimë se edhe mbiemrat lakohen sikur emrat. Mbiemrat lakohen vetëm të shoqëruar me emrat

Kur lakohen emrat, mbiemrat marrin tregues gramatikorë rasorë dhe të shquarësisë.

Trajta e shquar

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
Emërore	mali i lartë	fushë e gjerë
Gjinore	i/e malit të lartë	i/e fushës së gjerë
Dhanore	malit të lartë	fushës së gjerë
Kallëzore	malin e lartë	fushën e gjerë
Rrjedhore	malit të lartë	fushës së gjerë

Trajta e pashquar

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
Emërore	(një) çun lazdran	(një) çupë urtake
Gjinore	i/e (një) çuni lazdran	i/e (një) çupe urtake
Dhanore	(një) çuni lazdran	(një) çupe urtake
Kallëzore	(një) çun lazdran	(një) çupë urtake
Rrjedhore	(një) çuni lazdran	(një) çupe urtake

Detyra

1. Plotësoni lakimin e emrave **libër, mace, shtrat** dhe **mollë** me format e tyre në shumës, në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar!

Trajta e shquar

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
Emërore	libra të rinj	mace të buta
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

Trajta e pashquar

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
Emërore	(disa) shtretër të gjerë	(disa) mollë të ëmbla
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

2. Plotësoni vendet e zbrazëta me emra pranë mbiemrave dhe përdalloni mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm!

_____	magjike	_____	të vështira
_____	të largët	_____	i qetë
_____	e guximshme	_____	diellore
_____	ditore	_____	i vyer

3. Shkruani nga tri fjali me mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë!

1. _____.
2. _____.
3. _____.

4. Plotësoni fjalitë vijuese me mbiemrat: **të kthjellët, të lashtë, së madhe, i pakufishëm, të gjerë, e ëndërruar, të këndshme, e zgjedhura, magjik, e paharrueshme, vjetore, e parë.**

Në shtëpinë tonë u bë festë _____. Gëzimi ishte i _____.

Kishin ardhur pos hallës _____, edhe axhët e tezet. Unë ndihesha shumë i _____. Si të mos ndihesha? Kisha fituar vendin e _____ në garën _____ të qytetit _____ buzë detit të _____ e _____. Kënduam, vallëzuam, qeshëm, hangrëm ushqimet e _____ të nënës sime. Babai më kishte përgatitur befasi _____. Ma kishte blerë biçikletën _____ gjatë. Isha _____ si kurrë në jetën time.

5. Lako mbiemrat i ftohtë dhe e drunjtë në njëjës në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar duke i shoqëruar me emrat që dëshiron!

Trajta e shquar

E. mot i ftohtë

GJ. _____

DH. _____

K. _____

RR. _____

Trajta e pashquar

karrige e drunjtë

NUMËRORI

Mbani në mend!

Numërori është pjesë e ndryshueshme e ligjëratisë që tregon numër a sasi të caktuar fymorësh e sendesh. Numërorët nuk janë fjalë emërtuese.

Numërorët e mirëfilltë shprehin njësi të plota leksikore që janë elemente të sistemit të numërimit: *një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë* e kështu me radhë.

Numërorët përdoren:

- gjatë **numërimit**: *dhetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë* etj.
- në **veprimet matematike**: **Kryeni veprimet në vijim:** $300:15 =; 76+8=$ etj.
- si **përcaktues të sasisë** së fymorëve, qenieve të një lloji: *afro 100 njerëz, 80 krerë dele, 40 fije pambuku, një takëm prej 6 gotash* etj.

Numërorët, në të shumtën e herës, shoqërohen me emra: *dy anët e murit, shtatë shkurtabiqët, shtatë bjeshkët, dhjetë libra, dy çifte të rinjsh* etj.

Numërorët përdoren edhe për të treguar **data, periudha të caktuara, orën** etj.: *viti 2012, ai erdhi më 25.10.2011, ora është dhjetë e tridhjetë minuta* etj.

Numërorët, sipas mënyrës së formimit përbëjnë tri grupe fjalësh:

- **fjalë të parme**: *një, dy, tre* e deri në *dhetë*.
- **fjalë të përngjitura**: *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë* e kështu me radhë.
- **fjalë të përbëra**: *dyzet, njëqind, pesëqind* etj.

Duhet ta dini se edhe **thyesat** hyjnë në numërorët: *tri të katërtat, një e dhjeta, dy të tretat*, etj. Ato nuk shënojnë sasi të plota, por pjesë sendesh.

Mbani në mend!

Numërorët nuk i kanë kategorinë e **gjinisë** dhe as kategorinë e **numrit** (*një çun -një çupë, një laps - një fletore, një burrë - një grua* etj.). Përjashtim bën numërori **tre** që del edhe në formën e gjinisë femërore **tri**: *tre djem, tri vajza, tre libra, tri gota, tre portokaj, tri mollë*, etj.

Numërorët shoqërohen shpesh me nyjën **të** kur bëhet fjalë për një sasi të ditur që më parë: **Të pestët ishim aty. Të tria këngët u pëlqyen. Të dy çunat ishin të zot.**

Ushtime:

1. Siquhen numërorëtnëgjuhëne evenditkujetonti? _____

2. Plotësoni vendet e zbrazëta me numërorët tre/tri:

_____ vende _____ mace _____ këmishë _____ mjekë

_____ krehër _____ minj _____ topa _____ dollape

3. Sajoni një tekst prej gjashtë deri tetë fjalish ku do të përdoren numërorët: **dy a tre, tre, tre, shtatë, nëntë, treqind, 2010-2012!**

PËREMRI

Po rikujtojmë ato që kemi mësuar në Librin e Gjuhës për nivelin e dytë.

Përemrat janë fjalë të ndryshueshme që përdoren në vend të emrave e të mbiemrave. Ata përdoren për të treguar ose pér të pyetur pér frymori, sende ose dukuri.

Lexoni tekstin dhe përdallojini/nënvizojini përemrat!

”Unë kurrë s’ e kisha harruar copëtimin e tim eti nga peshkaqeni. Mbase thirrja pér hakmarrje qe dhe shkaku që u lidha më shumë me këtë vend.

Peshkatari plak tregonte dhe ne, të ulur rreth tij, e dëgjonim.

Thuhet se një stërgjyshi im doli nga barku i peshkut!

Kur tha këto, ne u habitëm. Dhe ai na shikoi. Qeshi dhe vazhdoi:

“Edhe ai na paskësh qenë peshkatar...

Ai nuk fliste me njerëzit. Fliste me detin. Por kur i takonte të bisedonte me ata që i shkonin pér zemër, s’kishte të pushuar...”

Petro Marko ”Shpallja e piratëve”

Përemrat që keni njojur në këtë tekst, siç keni vërejtur, zëvendësojnë emrat dhe janë të ndryshëm.

Në gjuhën shqipe përdoren shtatë llojet vijuese të përemrave:

- përmra **vetorë**: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato
- përemra **dëftorë**: ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata, ato, i, e këtillë, i tillë, i, e atillë etj.
- përemra **vetvetorë**: vete/vetja
- përemra **pronorë**: imi, ime, yti, i tij, i,e saj, i, e vet, yni, juaj, i, e tyre. mia etj.
- përemra **pyetës**: kush, kujt, kë, sa, si, çka, çfarë, pse etj.
- përemra **lidhorë**: që, i cili, e cila, çka, të cilëve, të cilave, kush, çfarë etj.
- përemra **të pacaktuar**: kush, dikush, askush, njëfarë, diçka, çdo, secili, tjetër, gjithë, gjithfarë etj.

Lexojeni tekstin në vijim duke nënvizuar **përemrat** dhe duke përdalluar llojin e tyre. Bëni pastaj në fletoren tuaj ose në një fletë një tabelë me përemrat që i keni gjetur (përemra **vetorë**:; përemra **pronorë**:; etj.,)!

”Vetëm **im** atë nuk donte të kishte të bënte me **të**. Atij nuk i pëlqente ta shihte të vinte në shtëpi e të fliste me djalin e tij. Trembej se mos më bënte si veten...

Mimoza qëndronte mbi kokat tonadhe kur ajo ishte në lulëzim, oborri kundërmonte. I doja shumë lulet e saj gjithë erë, ndërsa nëna i vendoste në baule dhe këmishët tona, çarçafët tanë, gjithë fëmijëria ime mbante aromë mimoze. Ne bisedonim për probleme të ndryshme me fjalë të qeta. Shpesh herë nëna më fliste për babanë e saj për fshatin ku unë kisha lindur, nganjëherë unë i tregoja për jetën e shenjtorëve që kisha lexuar dhe që e zbulu kuroja me imagjinatën time. Vuajtjet e tyre nuk më mjaftonin por shtoja edhe të tjera, aq sa nëna fillonte të qante...

Nikos Kazanzaqis «Letër El Grekos»

Detyra

1. Shkruani përemrat e duhur (atje, vetë, ai, ky, ne, ata, vete, jonë, tjetri, atje,) në vendet a zbrazëta në tekstin në vijim!

Skënderbeu e emëroi përsëri Moisiun komandant të ushtrive të kufirit po qeverisjen e Dibrës e mbajti për ...

... e pyeti gjatë Moisiun mbi sa kishte parë në Edrene, por asnjëherë nuk e solli fjalën rreth marrëdhënieve që pati ... me turqit. Për Moisiun, ... ishte një Skënderbe i ri, që kujdesej për plagët e për nderin e ..., që e bënte punën sikur ta kishte dërguar ... matanë.

Nuk është për Është për Hungarinë. Përgatitjet janë shumë-shumë të mëdha. Puna ... quhej e myllur – tha Moisiu.

... u panë gjatë dhe i pari i uli sytë Skënderbeu. Moisiu ishte ... i gjithi, ashtu si nuk kishte qenë kurrë ashtu, dhe Skënderbeu i vuri dorën në sup.

Sabri Godo ”Skënderbeu”

2. Shkruaj sipas dëshirës nga dy fjali duke përdorur përemra vëtorë, përemrat dëftorë, përemrat pronorë, përemrat pyetës dhe përemrat pacaktuar!

3. Si quhen përemrat në gjuhën e vendit ku jeton ti?

shqip	në gjuhën e vendit ku jeton ti
përemri	-
përemri vетор	-
përemri дëftор	-
përemri ветветор	-
përemri пронор	-
përemri пјетес	-
përemri лидзор	-
përemri i pacaktuar	-

LAKIMI I PËREMRAVE

Duhet ta dimë!

Disa përemra lakohen si emrat: **unë (mua, meje)**, **ti (ty, teje)**, **cili (cilit, cilin)**, **kush (kujt, kë)** etj.; disa përemra, sikur mbiemrat, shoqërojnë emrat dhe i përshtaten atyre në **gjini**, në **numër** e në **rasë** domethënë marrin gjininë, numrin e rasën e emrit që shoqërojnë.

Përemri vtor

rasha	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	unë	ne	ti	ju
gjinore	-	-	-	-
dhanore	mua, më	ty, të	ty, të	juve, ju
kallëzore	mua, më	ty, të	ty, të	ju, ju
Rrjedhore	meje	teje	teje	jush

Përemrat vtorë të vetës së parë e të dytë nuk përdoren në rasën gjinore

rasha	m	f	m	f
emërore	ai	ajo	ata	ato
gjinore	i/e atij	i/e asaj	i/e atyre	i/e atyre
dhanore	atij, i	asaj, i	atyre, u	atyre, u
kallëzore	atë, e	atë, e	ata, i	ato,i
rrjedhore	atij	asaj	atyre	atyre

Përemrat vtorë **ai, ajo, ata, ato** janë edhe përemra dëftorë.

Përemri dëftor

rasha	me emër	pa emër
emërore	ky shok	ky
gjinore	i/e këtij shoku	i/e këtij
dhanore	këtij shoku	këtij
kallëzore	këtë shok	këtë
rrjedhore	këtij shoku	këtij

rasha	me emër	pa emër
emërore	kjo shoqe	kjo
gjinore i (e)	i/e kësaj shoqeje	i/e kësaj
dhanore	kësaj shoqeje	kësaj
kallëzore	këtë shoqe	këtë
rrjedhore	kësaj shoqeje	kësaj

Përemri pronor

Veta e parë

gjyshi im	gjyshja ime	gjyshi ynë	gjyshja jonë
i gjyshit tim	i gjyshes sime	i gjyshit tonë	i gjyshes sonë
gjyshit tim	gjyshes sime	gjyshit tonë	gjyshes sonë
gjyshin tim	gjyshen time	gjyshin tonë	gjyshen tonë
gjyshit tim	gjyshes sime	gjyshit tonë	gjyshin tonë

Veta e dytë

gjyshi yt	gjyshja jote	gjyshi juaj	gjyshja juaj
i gjyshit tënd	i gjyshes sate	i gjyshit tuaj	i gjyshes suaj
gjyshit tënd	gjyshes sate	gjyshit tuaj	gjyshes suaj
gjyshin tënd	gjyshen tënde	gjyshit tuaj	gjyshes tuaj
gjyshit tënd	gjyshes sate	gjyshit tuaj	gjyshes suaj

Veta e tretë

gjyshi i tij	gjyshja e saj	gjyshi i tyre	gjyshja e tyre
i gjyshit të tij	i gjyshes së saj	i gjyshit të tyre	i gjyshes së tyre
gjyshit të tij	gjyshes së saj	gjyshit të tyre	gjyshes së tyre
gjyshin e tij	gjyshen e saj	gjyshin e tyre	gjyshen e tyre
gjyshit të tij	gjyshes së saj	gjyshit të tyre	gjyshes së tyre

Përemri pyetës

- E. **kush?** **Kush** po vjen? **cili?** **Cili** top është i tij?
- Gj. **i kujt** **I kujt** është ky top? **i cilit?** **I cilit** është ky laps?
- Dh. **kujt?** **Kujt** do t'i bie shorti të luajë? **cilit?** **Cilit** nuk i hahet ëmbëlsira?
- K. **kë?** **Kë** njoftove për shfaqjen? **cilin?** **Cili** nga ju do të këndoni?
- Rr. **kujt?** Prej **kujt** e morët vesh? **cilit?** Prej **cilit** ia nise?

• •

Detyra

1. Vendosni në fjalitë e poshtëshënuara këta përemra vëtorë, dëftorë, pronorë dhe pyetës:

mua, atij, e saj, yt, ky, këtyre, mia, tonat, e tyre, kush, cilit, pse.

Ai më tha Këto janë lulet e Ky është kompjuteri ?

Kjo u përket Ato nuk janë nuk erdhe me kohë?

Ato janë kushërirat Mendimet e vlejnë pak. prej jush i erdhi radha?

A është topi im? Këta janë prindërit e e ka lexuar poezinë?

2. Bëni në fletoren tuaj një tabelë dhe lakoni përemrat pronorë
ime, juaj, e tyre!

3. Sajoni dhjetë fjali me përemrat pyetës:

kush, cili/a, çfarë, ç', sa, si, i sati, me se!

FOLJA

Kohët e mënyrat

Foljet janë pjesë të ndryshueshme të ligjëratisë që tregojnë **veprime** ose **gjendje**.

Foljet kanë kategorinë gramatikore **të vetës, të kohës, të numrit, të mënyrës** dhe **të diatezës** (diatezë vepror: unë rrah; diatezë pësore: unë rrähem).

Folja tregon **veprime** por edhe **kohën** kur kryhen këto veprime. Krahaso: unë punoj – unë punova – unë do të punoj.

Foljet kanë tri kohë: **Kohën e tashme (jam), kohën e shkuar (unë isha / unë qeshë / unë kam qenë / unë kisha qenë / unë pata qenë)**, dhe **kohën e ardhme (do të jem / do të kem qenë)**.

Koha e tashme tregon se **veprimi kryhet në çastin kur flasim**.

Koha e shkuar tregon se **veprimi është kryer para çastit kur flasim**.

Koha e ardhshme tregon se **veprimi do të kryhet pas çastit kur flasim**.

Mbani në mend!

Foljet grupohen në tri zgjedhime:

1. Foljet që mbarojnë me shkronjën **-j**: *shkoj, mësoj, këndoja, blej, punoj, vallëzoj* etj.
2. Foljet që mbarojnë me bashkëtingëllorre: *mbyll, hap, mat, rräh, qep, përgatit* etj.
3. Foljet që mbarojnë me zanore: *ha, pi, rri, zë, vë, lë, di, shpie* etj.

► Për zgjedhimin e foljeve **jam** dhe **kam** shih Librin e Gjuhës për nivelin e dytë, f. 35!

Gjatë përdorimit folja ndryshon formën, sepse veprimi i saj shprehet në **mënyra** të ndryshme. Në gjuhën shqipe sipas kuptimeve që shprehin kemi **gjashtë mënyra foljore të shtjelluara** e që janë:

- | | |
|-------------------------|------------------------------|
| mënyra dëftore | (unë <i>punoj</i>) |
| mënyra lidhore | (dua <i>të punoj</i>) |
| mënyra kushtore | (<i>do të punoja</i>) |
| mënyra habitore | (<i>punuakam, punuake</i>) |
| mënyra dëshirore | (<i>punofsha, punofsh</i>) |
| mënyra urdhërore | (<i>puno! punoni!</i>) |

dhe **tri mënyra foljore të pashtjelluara**:

- | | |
|---------------------|---|
| pjesorja | (<i>kam punuar</i>) |
| paskajorja | (<i>për të punuar; gegërisht: me punue</i>) |
| përcjellorja | (<i>duke punuar</i>) |

MËNYRA DËFTORE

Mënyra dëftore ka këto kohë:

koha e tashme – lexoj

koha e shkuar:

koha e pakryer – lexoja

koha e kryer e thjeshtë – lexova

koha e kryer – kam lexuar

koha më së e kryer – kisha lexuar

koha e kryer e tejshkuar – pata lexuar

Koha e ardhme

Koha e ardhme – do të lexoj

Koha e ardhme e përparme – do të kem lexuar

Detyra

1. Lexoni tekstet në vijim dhe nënvízioni foljet!

*Kur **dëgjon** zëthin e s'ëmës qysh e le qengji kopenë,*

Blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë,

Edhe në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë,

E ta trëmbin, aqy s'kthehet, po shkon në mes si shigjetë,

Ashtu dhe zëmëra ime më le këtu tek jam mua,

Vjen me vrap e me dëshirë aty nér viset e tua.

Naim Frashëri «Bagëti e bujqësia»

*Drita **duel**, dielli s' ká lé,*

Alì Pasha, 'i trim rrfé,

Heret sod na kënka çue,

Kënka veshë, kënka shterngue,

Paska mathë çizmet dér m' giû,

Edhè u ulka në katue,

Ka nisë gjokun me shilue,

Gjergj Fishta «Lahuta e Malcis»

2. Përdalloni në ç'kohë të mënyrës dëftore janë foljet në fjalitë e mëposhtme:

- | | |
|--|------------|
| Vajza shkruan ditar. | koha _____ |
| Gjyshja gërhiste me të madhe. | koha _____ |
| Ti erdhe me vonesë. | koha _____ |
| Ne kishim drojë nga bumbullima. | koha _____ |
| Ajo ka ardhur mbrëmë | koha _____ |
| Babi do të ketë dëgjuar për lajmin. | koha _____ |
| Do të vijë koha e tyre. | koha _____ |

3. A e keni mbajtur në mend ç'janë **kohët e thjeshta e kohët e përbëra?**

Shkruani përgjigjen në fletoret tuaja!

MËNYRA LIDHORE

Mënyra lidhore shpreh **mundësi veprimi, dëshirë veprimi ose detyrim veprimi.**
Ajo ka dy kohë:

1. e tashmja – **të kem, të jem, të mësoj, të vij, të them, të pi**
2. e shkuara ka tri kohë:
 - a) e pakryera – **të kisha, të isha, të mësoja, të vija, të thosha, të pija**
 - b) e kryera – **të kem pasur, të kem qenë, të kem mësuar, të kem thënë, të kem pirë**
 - c) më së e kryera – **të kisha pasur, të kisha qenë, të kisha mësuar, të kisha thënë, të kisha pirë**

Ushtrojmë!

Zgjedhojmë foljet **kam, jam, dal, them** dhe **pi** në kohën e tashme të lidhores:

Unë	të kem	të jem	të mësoj	të dal	të them	të pi
Ti	të kesh	të jesh	të mësosh	të dalësh	të thuash	të pish
Ai	të ketë	të jetë	të mësojë	të dalë	të thotë	të pijë
Ne	të kemi	të jemi	të mësojmë	të dalim	të themi	të pimë
Ju	të keni	të jeni	të mësoni	të dilni	të thoni	të pini
Ata	të kenë	të jenë	të mësojnë	të dalin	të thonë	të pinë

A mund të vëreni dallimin midis kohës së tashme të lidhores dhe të tashmes së dëftores?

Format e së tashmes dhe të së pakryerës së lidhores kanë ngashjmëri me format e së tashmes e të së pakryerës së dëftores. Të shohim:

e tashme e lidhores e tashme e dëftores e pakryer e lidhores e pakryer e dëftores

të lexoj	lexoj	të lexoja	lexoja
të lexosh	lexon	të lexoje	lexoje
të lexojë	lexoi	të lexonte	lexonte
të lexojmë	lexojmë	të lexonim	lexonim
të lexoni	lexoni	të lexonit	lexonit
të lexojnë	lexojnë	të lexonin	lexonin



T'i shohim kohët e tjera të mënyrës lidhore:

e kryera	më se e kryera	e kryera	më së e kryera
të kem qenë	të kisha qenë	të kem lexuar	të kisha lexuar
të kesh qenë	të kisha qenë	të kesh lexuar	të kisha lexuar
të ketë qenë	të kishte qenë	të ketë lexuar	të kishte lexuar
të kemi qenë	të kishim qenë	të kemi lexuar	të kishim lexuar
të keni qenë	të kishit qenë	të keni lexuar	të kishit lexuar
të kenë qenë	të kishin qenë	të kenë lexuar	të kishin lexuar

Detyra

1. Zgjedhoni në fletoren tuaj kohën e tashme dhe kohën e kryer të foljeve **luaj** dhe **zë!** Bëni një tabelë si këtë:

k. e tashme	k. e pakryer	k. e tashme	k. e pakryer
të luaj	të luaja	të zë	të zija
të luash	të luaje
etj.			

2. Lexoni tekstin në vijim, gjejini foljet e mënyrës dëftore e lidhore dhe shënojini ato poshtë tekstit!

Ushtrinë duhet **ta krijojmë** dhe të marrim përsipër shpenzimet. Për këtë kemi ardhur këtu. Le të na prijë Skënderbeu i fortë, që na solli lirinë dhe që njeh dredhitë e turkut. Ne do t'i shkojmë pas. Le të jetë kapiten dhe kryetar, si shqiponja me dy krerë. Unë do t'i jap haraçin që i paguaja turkut dhe gjithë fuqinë time, tre mijë ushtarë...

Biseda po anonte nga përcarja. Xhamat me ngjyra, të dritareve të rrahura prej diellit, ngrinin në mesin e sallës një shtresë ajri ku dukej sikur vërtitej pluhur. Përmes saj Skënderbeu shikonte Kuvendin si përtej ujtit.

Sabri Godo «Skënderbeu»

Foljet në **dëftore** _____

Foljet në **lidhore** _____

3. A ka mënyrë lidhore në gjuhën e vendit ku jeton ti? Si quhet ajo? Shëno emrin dhe ca shembuj!

4. Përdorni në tekstin në vijim në vendet e zbrazëta format foljore të lidhores: **dukem, ngul, di, bëj, ndesh, ndiej, vij, jam!**

Dukej se daja i pamëshirshëm këmbë në të tijën, donte se çdo nipi po të të vëllanë. "Kushedi ç'bëhet deri në janar, mbasë nuk e takoj kurrë" mendoi Kojkoja që e shtynte gjithnjë për më tej zgjidhjen e punëve të vështira...

Ai mbylli sytë që prapë, po ndjeu nëpër trup, nga këmbët në kokë zhurmën e njohur të kuajve. Ai u ngrit ndenjur. S'mund lajme nga kjo anë e lumi. Diçka do të kishte ngjarë në ushtri, një grindje, një gjëmë, derisa shpejtonin dhe flisnin mbytur. Po mund edhe të prapambetur që bënин zhurmë dhe i prishnin ushtrisë gjumin në prag të betejës.

Sabri Godo «Skënderbeu»

NDAJFOLJA

Ndajfolja është pjesë e pandryshueshme e ligjëratisë që plotëson foljen. Ajo nuk ka gjini, numër, rasë e vetë. Ka vetëm kategorinë e shkallës.

Ndajfolja qëndron zakonisht me foljen dhe tregon **vend**, **kohë**, **mënyrë**, **shkak**, **sasi**:

- Ndajfolje **vendi**: *këtu-atje, para-prapa, majtas-djathas, afër-larg, poshtë-lart, këndej-andej*, etj,
- Ndajfolje **kohe**: *tash, menjëherë, sot, dje, nesër, dikur, kurrë, sivjet, vjet, parvjet, herët, vonë, verës, dimrit, tashmë*, etj.
- Ndajfolje **mënyre**: *shpejt, ngadalë, rrufeshëm, befas, kështu, ashtu, bukur, drejt, anash*, etj.
- Ndajfolje **shkaku**: *sepse, prandaj, pse, përse*, etj.
- Ndajfolje **sasie**: *pak, shumë, mjaft, tepër, fort, aq, kaq, së tepërmë, dy herë, tri herë, dyfish*, etj.

Detyra

1. Lexojeni tekstin, gjeni ndajfoljet e vendit dhe shënojini ato poshtë tekstit:

Autobusi ecte **larg** bregut të detit... Ç'vende të bukura paska këtej. Më vjen çudi që kam pranë meje një shqiptar...

- Eh! Ç'është këtu – pyeti Alfredi duke shikuar andej-këtej. ... Shikoni këtej poshtë detin si futet gjer te portokallet dhe atje tej, ato vila, që humbasin në ato kopshte.
- Këtej ! Këtej ! - u thoshte vajza që u printe.

Petro Marko «Hasta la Vista»

larg,

Ndajfoljet e vendit i gjejmë në tekst me pyetjet: **ku?**, **kah?**, **prej nga?**, **nga** (erdhi)?, **deri ku?**

2. Lexojeni tekstin, gjeni ndajfoljet e kohës dhe shënojini ato poshtë tekstit:

Sot, pas një kohe kaq të gjatë, edhe ne therrëm një këndes. Pasdite njerëzit do të trokisin te porta dhe do të pyesnin për shpatullën. Pastaj do të pyesnin gjyshen në ndonjë kasolle, nënën kur të dilte tek pragu i portës dhe ndoshta në kafene burrat do ta pyesnin babanë ... E kuptova menjëherë porsa hyra në oborr.

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

Sot,

Ndajfoljet e kohës i gjejmë në tekst me pyetjet: **kur ?, prej kur?, deri kur?**

3. Lexojeni tekstin, gjeni ndajfoljet e mënyrës dhe shënojini ato poshtë tekstit:

Papritur dhe çuditshëm kishte filluar ...Sytë e Hanës shikojnë përkëdhelshëm; qerpiqët e saj çohen e palohen gati padiktueshëm...Papritmas sytë më qepen në një shkrim, të cilin nuk e kisha patur në tryezë, të cilin nuk e kisha shkruar unë, të cilin, o Zot, vetën engjëlli a djalli mund ta kishin lënë, ashtu padiktueshëm, aty ku ishte!

Rexhep Qosja «Një dashuri dhe shtatë faje»

Papritur,

Ndajfoljet e mënyrës i gjejmë në tekst me pyetjet: **si?, në ç'mënyrë?**

4. Lexojeni tekstin, gjeni ndajfoljet e shkakut dhe shënojini ato poshtë tekstit:

Kështu, po rastisi të them ndonjë gënjeshtër, ju duhet të më falni sepse keni parasysh një gjë, kjo vjen nga që kam ndenjur ca si gjatë në Kongon belge ... edhe pse në pyllishte kishte thëllëza sa të duash, prapëseprapë gjërat më me vlerë, jo gjithmonë, po pothuajse, gjendeshin pranë vendeve ku banonin njerëz.

Astrid Lindgren «Pipi Çorapëgjata»

Kështu,

Ndajfoljet e shkakut i gjejmë në tekst me pyetjet: **si?, pse?, përsë?**

5. Lexojeni tekstin, gjeni ndajfoljet e sasisë dhe shënojini ato poshtë tekstit:

Unë kam qenë **shumë herë** krushk e kam kaluar shpesh këtej me nuse të re... Nuk më ka ndodhur kurrë ndonjë e keqe. Pra fillojani gazit! ...Pret të vijnë dasmorët me nuse. Sa më shumë pret, aq më shumë ngryset Muji... Aty mban gjogun, zurret të pushojë pak ... Kalojnë plot tri ditë.

Mitrush Kuteli «Tregime të moçme shqiptare»

shumë herë,

Ndajfoljet e sasisë i gjejmë me pyetjen: **sa?**

Duhet të dini edhe këtë:

Ndajfoljet mund të plotësojnë edhe mbiemrat ose ndajfoljet e tjera, sikur në shembujt në vijim:

Ai kishte notuar **shumë** larg. Djaloshi ishte **tepër** i shpejtë.
Unë flija gjumë shumë të thellë. Gjyshja thurte **fort** bukur.

Detyra

1. Plotësoni fjalitë me ndajfoljet që shoqërojnë mbiemrat ose që dyfishtojnë ndajfoljet.

Ylli banon në një shtëpi _____ të vjetër.

Ne u vonuam _____ më shumë se ata.

Durrësin e dua _____ më tepër se qytetet e tjera.

2. Si quhen ndajfoljet në gjuhën e vendit ku jeton? Shëno emrin dhe ca shembuj!

3. Skruaj një tekst të shkurtër me të paktën shtatë ndajfolje të ndryshme!

F J A L I A – P E R I U D H A

Fjalia është bashkim i disa fjalëve që na tregojnë diçka. Ajo fillon me një shkronjë të madhe dhe mbaron me një pikë (.), me një pikëpyetje (?) ose me një pikëçuditje (!). Fjalia ka një bërthamë kallëzuesore, i cili përbëhet nga një folje:

1. Nëpër mendjen time **kalojnë** personazhet e romaneve të lexuara.
2. Papritmas, në vend të saj, **jam** i befasuar unë.

Njësi sintaksore, pos fjalisë, janë edhe **periudha** dhe **gjymtyra e fjalisë**.

Ç'është periudha? _____

Mbani në mend !

Periudha është **bashkimi** në **një tërësi kuptimore, strukturore e intonacionale** i dy a më shumë fjalive, në marrëdhënie të caktuara mes vete. Periudha ka **dy** e më shumë bërthama kallëzuesore:

1. Qyteti **shtrihej** krejtësisht i pambrojtur nën qiellin vjeshtor, i cili **u dukej** të gjithëve më i hapur se zakonisht.
2. Kur dreka **mbaroi**, **u ktheva** prapë tek grumbulli i pjatave të palara, ku **gjeta** shpatullën e këndesit dhe me të në dorë **u ngjita** në katin e tretë të shtëpisë.

Fjalia si dhe periudha kumtojnë diçka. Ato dallojnë për nga struktura.

Analizoni bashkërisht ngashmérinë dhe dallimin midis fjalisë dhe periudhës!

Nënvizoni dhe numëroni kallëzuesit e tyre:

1. Bora pushoi shumë shpejt.
2. Atë ditë profesori na e trego ngjarjen e plotë.
3. Kthehem në dhomë, shtrihem në kanape, shikoj zbrazëtinë e dhomës, mandej nëpër xham gjithësinë.

Bisedojmë!

- Çka keni vërejtur?
- Sa kallëzues kanë fjalia e parë dhe ajo e dytë?
- Po fjalia e tretë, sa kallëzues ka?
- Cila nga këto fjali quhet periudhë?

Ushtrime

1. Shkruani nga dy fjali e dy periudha!

F _____
F _____
P _____
P _____

Mësojmë!

1. Fjalia mund të dalë me gjerësi e me strukturë të ndryshme: mund të jetë **shumë e shkurtër, më pak e shkurtër ose më e gjatë**.

U err. **Sapo** u err. **Dje** u err **më shpejt se herë të tjera**.

Doli dielli. **Sot** doli dielli **herët** **Sot** doli **shumë më herët** dielli.

2. Periudha mund të dalë me përbërje e strukturë të ndryshme: të jetë më e gjatë ose më pak e gjatë. Gjatësinë e saj e përcakton numri i fjalive, përkatësisht i kallëzuesit.

Nëse **s'ke** pulë, **merr** një mace e **mbylle** brenda.

Kur **arrita** në qytet, **gjeta** shokët e Gencit dhe **u nisëm** menjëherë.

S'kisha parë asnjëherë një agim të tillë dhe as nuk **isha ndier** ndonjëherë ashtu i qetë.

Periudha dhe fjalia ndahen prej njësive të tjera kumtuese me **pikë**, me **pikëpyetje** a me **pikëçuditje**.

Detyrë

1. Lexoni tekstin në vijim. Nënvízioni fjalitë me ngjyrë të kuqe, kurse periudhat me ngjyrë të kaltër!

Në një cep të oborrit të shtruar me gurë të dendur ishte një karrocë e mbuluar që shkëlqente në diell. Ajo qëndronte mbi dy rrota të mëdha elegante dhe dy kuaj të lartë biondë, që ishin lidhur pas saj, prisnin me kokën ulur. Është karroca e Pashait. E ka blerë në Francë...

Kur dolën jashtë, hëna po lahej mbi liqen. Ke qenë në fshat, pyeti Petro. Jo, u përgjigj Thanasi. Babai ka bërë një shtëpi të madhe me shumë dhoma. Ka një dhomë edhe për ne të dy. Petro ktheu kokën nga perëndimi, andej nga duhej ishte fshati dhe hëna i ndriçoi ballin.

Ben Blushi «Të jetosh në ishull»

LLOJET E FJALIVE

Mbani në mend!

Llojin e fjalive e përcakton lloji i kumtimit. Kumtimi ynë me gojë ose me shkrim shpreh mendime, ndjenja e informacione.

Më parë kemi mësuar se sipas kuptimit fjalitë ndahan në:

1. Fjali dëftore – fjalia që kumton një ngjarje, një veprim ose një dukuri. Në fund të kësaj fjalie vendosim pikë (.). Ja tre shembuj:

Ari shkon në shkollë fillore. Sot është Dita e Flamurit. Të gjithë e duan ajrin e pastër.

2. Fjali pyetëse – fjalia me të cilën shtrojmë pyetje të ndryshme. Në fund të kësaj fjalie vendosim pikëpyetje (?).

Si e ka emrin vogëlushja? Në ç'orë do të fillojë shfaqja? Çka do të thotë vonesa jote e çdoditshme?

3. Fjali urdhërorë - fjalia me të cilin shprehim këshillë, urdhër, lejim ose lutje. Në fund të kësaj fjalie vendosim pikëçuditje (!).

Mos humb kohën kot! Më jep të ha, të lutem! Mbylle derën më shpejt!

4. Fjali thirrmore – fjalia me të cilën shprehim nxitje ose ndjenja të caktuara, të mira ose të këqija. Në fund të kësaj fjalie vendosim pikëçuditje (!).

Ti je nëna më e mirë në botë! Paskeni vizatuar shumë mirë! Të lumtë Rea, vetëm përpara!

5. Fjali dëshirore – fjalia me të cilën shprehim dëshirë për të realizuar diçka. Në fund të kësaj fjalie vendosim pikëçuditje (!).

Urime festa të dashurit e mi! Dalsh faqebardhë në garën e radhës! Ç'i bëre maces, qofsh i mallkuar!

Ushtrojmë

1. Lexoni me kujdes tekstin në vijim dhe përdalloni llojin e fjalive duke i shënuar në tabelën në faqën tjeter.

Mëngjesi erdhi i ftohtë dhe i vrenjtur. Binte shi i hollë. Trokiti porta.

- A jeni gati? – thirri Bido Sherifi që nga rruga.
- Gati, - u përgjigj babai.
- E po , hajde të të puth, - i tha gjyshja...
- Po pse ti nuk do të vish?...
- Unë do të rri këtu.
- Jo, Jo, Jo!
- Pusho! – tha babai.
- Pusho të keqën, s'më gjen gjë mua.
- Jo, jo!

Porta trokiti pse.

- Shpejt! – tha babai, - po na presin.
- Pse e lini gjyshen? – thërrita me ankim.
- Nuk do vetë të vijë, - tha babai ...
- Të veni me shëndet! - tha gjyshja dhe na puthi të gjithëve me radhë.

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

Mëngjesi erdhi i ftohtë dhe i vrenjtur	Fjali dëftore
A jeni gati?	Fjali pyetëse
- Shpejt!	Fjali urdhërore

Detyrë

Shkruani një ese prej dhjetë fjalish me titullin *Në festën e nënës* me llojet e fjalive që mësuam!

FJALIA KRYESORE, FJALIA E PAVARUR, FJALIA E VARUR

Duhet ta dini!

Fjali kryesore në një periudhë quhet fjalia që mund të qëndrojë nga ana gramatikore e vetme, pa fjalitë e tjera, por që kuptimi i saj plotësohet prej një a më shumë fjalive të tjera.

Sot ndihem i lumbur që mbarova me sukses kursin e anglishtes.

Fjali e pavarur në një periudhë quhet fjalia që qëndron e pavarur nga ana gramatikore dhe kuptimore dhe që nuk plotësohet e as nuk varet prej fjalish të tjera.

Eci e eci deri vonë, kur u lodh e mezi e mbanin këmbët, u mbështet për rrapin e madh që i doli para. Ç'të shihte! **Nuk u besonte syve**.

Vini re!

Fjalitë e pavarura shpesh janë shkëputura prej periudhës.

Fjali e varur në një periudhë quhet fjalia që varet nga ana gramatikore e nga ana kuptimore prej një fjalie tjetër, pra fjalia që nuk mund të qëndrojë e vetme.

Në ditën që udhëtuam nëna e motra kishin përgatitur ushqimet, **që i duam fort**.

A e dini?

Ku qëndron dallimi midis fjalisë kryesore e fjalisë së pavarur?

Ja dallimi: **fjalia kryesore ka fjali që e plotëson, kurse fjalia e pavarur nuk ka**.

Në një periudhë mund të kemi disa fjalitë e pavarura.

Lexojmë fjalinë dhe përdallojmë fjalitë e varura!

Nxënësit u ftuan të linin klasat e të mblidheshin në sallën e shfaqjeve që gjendej në katin e dytë.

Fjalia kryesore – Nxënësit u ftuan.

Fjalitë e varura – 1. të linin klasat; 2. të mblidheshin në sallën e shfaqjeve që gjendej në katin e dytë.

Mbani në mend!

Fjalia e parë e varur «të linin klasat» quhet **fjali e varur e shkallës së parë**.

Fjalia e dytë e varur «të mblidheshin në sallën e shfaqjeve që gjendej në katin e dytë» quhet **fjali e varur e shkallës së dytë**.

Ushtrojmë bashkërisht!

1. Lexoni fjalinë në vijim dhe përcaktoni fjalinë kryesore dhe fjalitë e pavarura të shkallës së parë dhe të dytë:

Dielli shkëlqente, kur Vali po vishej, aq i lehtë e i gëzuar që po shkonte për herë të parë në skijim, sa mezi po përmbahej të vërvshëllente.

a) Dielli shkëlqente

fjali _____

b) kur Vali po vishej, aq i lehtë e i gëzuar që po shkonte për herë të parë në skijim

fjali _____

c) sa mezi po përmbahej të vërvshëllente

fjali _____

2. Lexoni tekstin në vijim, duke përdalluar fjalitë kryesore, fjalitë e pavarura dhe fjalitë e varura duke i shënuar në tabelë dhe në fletoret tuaja!

Porta u mbyll. Ishim në rrugë. Shiu i hollë binte pa pushim. U nisëm. Rrugës me grumbullin tonë u bashkuan njerëz të tjerë. Muret e kështjellës mezi dukeshin midis mjegullës. Vargu i njerëzve përpara portës perëndimore ishte i gjatë, me qindra metra. Njerëz të ngarkuar me dengje, batanije, sandukë, valixhe. Libra, tenxhere, frona, qilima, legenë, gjyma, djepa, jorganë, mokra, dybekë, lëviznin ngadalë përpara, ndalonin në vend për një kohë të gjatë, prapë lëviznin. Porta ishte larg. Shiu i hollë lagte gjithçka. Njerëzit kolliteshin, ngrihen në majë të thembrave për të parë ç'bëhej në krye të varganit, pyesnin »përse ndaluan?», pastaj ngaqë s'dinin ç'të bënин, prapë kolliteshin.

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

Fjali kryesore: _____

Fjali të pavarura: _____

Fjali të varura: _____

PERIUDHA ME FJALI TË BASHKËRENDITURA

Kemi mësuar më parë se:

Periudha përbëhet prej dy e më shumë fjalish, të cilat duhet të kenë kallëzues.

Duhet ta mësojmë tash:

Sipas **mënyrës së bashkimit të fjalive** në periudhë dallojmë dy lloje fjalish:

1. fjali me bashkërenditje

2. fjali me nënrenditje

Fjalitë quhen **të bashkërenditura** kur shprehin raporte barazie, kur kanë vlerë të njëjtë dhe kur nuk varen njëra prej tjetrës.

Fjalitë e bashkërenditura bashkohen me lidhëza dhe vijnë njëra pas tjetrës.

Shembuj:

Vrapuam të gjithë tek shoku **dhe** qëndruam rreth e rrotull si të ngrirë.

Ai ishte bërë dyll i verdhë **dhe** tregonte me gisht në tokë

Rozafi e kyç derën e shtëpisë **dhe** ia lëshon shulin e pishës mbrapa.

Fjalitë e bashkërenditura nuk bashkohen vetëm me lidhëzat **e, dhe, edhe**, por edhe me lidhëza të tjera si fjala vjen **as...as, por, porse, kurse mirëpo, ndërsa, apo, pra, megjithëkëtë**, etj. T'i shohim disa shembuj:

Në pyll nuk dëgjohej **as** cicërima e zogjëve, **as** shushurima e ujit.

Shiu dhe era kanë pushuar, rrugët janë tharë, qielli i bruztë përkohësisht është pastruar, **kurse** Dielli ngadalë zbret pas Bjeshkës së Madhe.

Kali të shpije atje ku do ti, **ndërsa** vetura atje ku do ajo.

Nuk kishte ski, **prandaj** nuk vajti për të rrëshqitur.

Të mësojmë **apo** të lozim?

Mbani në mend !

Periudhat mund të kenë më shumë se dy fjalë të bashkërenditura. Shembull:

Ti mund të ecje rrugës **dhe** po të doje, mund të zgjatje pak krahun **dhe** ta vije kapelën tënde mbi majën e një plepi.

Të analizojmë bashkërisht!

Sa fjali bashkërenditëse ka fjalia e sipërshënuar dhe cilat janë ato?

1. Ti mund të ecje rrugës.

2. (Ti) mund të zgjatje pak krahun.

3. (Ti mund) të vije kapelën tënde mbi majën e një plepi.

Çka keni vërejtur?

Periudha që lexuam ka **tri fjali** të pavarura me raporte barazie. Ato lidhen mes vete me lidhëzën **dhe** që përsëritet **dy herë**.

Detyra

1. Lexoni periudhën në vazhdim, ndani fjalitë e bashkërenditura, nënvizoni lidhëzat dhe shënoni poshtë cilat lidhëza janë përdorur për të bashkuar këto fjali!

Ato do të kalonin shumë ditë dhe muaj të mërzitshëm atje poshtë, derisa nëna ime t'i nxirrte me kovë, pas shumë kohe, të hutuara e të shushatura nga errësira, dhe të lante pastaj me to rrobat tonë, shkallët dhe dyshemetë e shtëpisë.

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

Lidhëzat: _____

2. Shkruani nga dy periudha me lidhëzat:

dhe, por, kurse, prandaj, megjithatë, as ... as!

1. _____

2. _____

1. _____

2. _____

1. _____

2. _____

1. _____

2. _____

1. _____

2. _____

1. _____

2. _____

PERIUDHA ME FJALI TË NËNRENDITURA

Mbani në mend!

Fjalitë quhen të nënrenditura kur nuk shprehin raporte barazie, kur nuk kanë vlerë të njëjtë dhe kur njëra fjali varet prej tjetrës.

Fjalitë e nënrenditura plotësojnë kuptimisht fjalitë e tjera. Periudha ka zakonisht një fjali kryesore dhe një a më shumë fjali të varura, të nërenditura. Shembull:

Në pjesën veriore të lagjes, kalonte rruga e kalasë, *që lidhte lagjet e sipërme të qytetit me qendrën.*

Fjalitë e nënrenditura bashkohen në periudhë në disa mënyra :

1. me **lidhëza**, që shprehin marrëdhënie të ndryshme kohore, shkakore, qëllimore, kushtore, mënyrore, etj.: **kur, që, se, sikur, nëse**

Kur erdha nga qyteti, të gjithë kishin ikur.

Blerta po gëzohej së tepërm **që** kishte ardhur koha të nisej për në Kosovë.

Sikur ta nijhja, do të shkoja te ajo

2. me **përemra lidhorë**: **që, se, kush, ç', i cili**

Fëmija **që** llastohet shumë ndihet i palumtur.

Nëna nuk tha **se** ti do të vije atë ditë.

Kush nuk e ka parë, nuk e kuption vlerën e tij.

3. me **ndajfolje**: **ku, nga, nga ku, aty ku, prej kah**

Gjyshja shikonte **nga ku** kishte hipur me shkallë.

Ajo doli papritur **nnga** kasolla **ku** ishte strehuar.

E gjata librin **aty ku** se prisja

4. me **pjesëza**: **pikërisht, vetëm e vetëm, madje, vallë**

Ajo po sillej **pikërisht** si e ëma.

Ne po nguteshim **vetëm e vetëm** të mos shqetësohej gjyshja.

Ajo gatuante mirë, **madje** edhe gurabijet.

Ushtrojmë!

Shkruani 2-3 fjali me lidhëzat **që, kur, sikur**

Shkruani 2-3 fjali me përemrat lidhorë **i cili, kush, se**

Shkruani 2-3 fjali me ndajfoljet: **nga ku, nga aty, prej kah, aq sa**

Shkruani 2-3 fjali me pjesëzat: **pikërisht, madje, vallë**

Detyra

1. Në tekstin në vijim nënëvizoni me të kuqe fjalitë e nënrenditura!

Gjyshja ime më tregonte se vetë e trumcakëve janë tepër të brishtë që të mund të merren nëpër duar.

Ne kishim dëshirë të shkonin shpesh atje ku gjenim shumë trumcakë, thëllëza. Në ditë të tilla vraponim pa u ndalur sa atje e sa këtu. Lodheshim shumë aq sa në mbrëmje na zinte gjumë pa rënë mirë në shtrat.

Në mëngjesin tjeter kur dielli ngrihej mbi kodrën përballë, ne pa ngrënë e pa pirë do të merrnim vrapin të shkonim të gjenim trumcakë e thëllëza të posaçelura sikur të mos na pengonte gjyshja. Ishim të lumtur vetëm kur mund të bridhnik pa asnje ndalesë të repte të gjyshes. Ajo frikësohej shumë se do të lëndoheshim ose do të bënim ndonjë të papritur që nuk do t'i pëlqente asaj.

2. Shkruani nga tri fjali të bashkërenditura dhe tri të nënrenditura!

1. _____.

2. _____.

3. _____.

1. _____.

2. _____.

3. _____.



SINTAKSA E FJALISË

Kryefjala e kallëzuesi

Kemi mësuar se: Çdo fjali ka gjymtyrët e saj.

Të rikujtojmë: ç'është **gjymtyra e fjalisë** dhe cilat janë **gjymtyrët kryesore të fjalisë!**

Gjymtyra e fjalisë është njësia sintaksore që kryen funksion të pavarur në fjali. **Gjymtyra** është njësia më e vogël e fjalisë.

Gjymtyrët kryesore të fjalisë janë: **kryefjala** dhe **kallëzuesi**. Ato quhen edhe **qendrat organizuese** të fjalisë.

Kryefjala është gjymtyra e fjalisë që tregon **për kënd a për çka flitet në fjali**.

Kryefjala shprehet me **emrin** dhe **përemrin**. Funksioni i emrit në fjali del i shquar edhe i pashquar.

Në fjali kryefjalën e gjejmë me pyetjet: **cili? cila? kush?** (për frymori) ose **çfarë?** **ç'?** (për sendet).

Libri më pëlceu shumë. Më pëlceu ai **libër** shumë.

Ai më pëlceu shumë. **Atë** e pëlqeji shumë

Kallëzuesi, siç e dini, tregon se ç'bën kryefjala, çfarë është kryefjala ose ç'pëson kryefjala. Kallëzuesi shprehet me **foljen**.

Kallëzuesi, zakonisht, qëndron pas kryefjalës dhe e gjejmë me pyetjet **ç'bën?**, **ç'është?** dhe **si është?**

1. Lexojmë tekstin në vijim duke përdalluar dhe duke nënvizuar **kryefjalën me të kuqe dhe **kallëzuesin** me të gjelbër. Tashmë e dini se me cilat pyetje i gjejmë ato: **kush** (**po vinin**)?, **çka** (**bënin qerret**)?**

Në drejtim të kundërt **po vinin qerret** bosh. Ato ishin shkarkuar dhe tani shkonin të ngarkoheshin përsëri... Këto ishin të vetmet fjalë që ata këmbyem gjatë gjithë rrugës... Kampi ishte i errët krejt. Ata kujtonin se gjithçka kishte rënë në gjumë. Por nuk ishte ashtu.

Ismail Kadare «Kështjella»

• •

Kujdes! Fjalia mund të ketë më shumë se një kryefjalë:

Gjumi s'po më zinte. Libri ishte aty pranë. I heshtur. Mbi minder. Diçka e hollë. Fare e hollë. E çuditshme. Brenda dy kapakëve prej kartoni të hollë rrinë **zhurma, potera, ulërima, kuaj, njerëz**. Pranë e pranë. Të shtypur me njëri tjetrin. Të zbërthyer nëpër shenja të vogla, të zeza. **Flokë, sy, klithma, trokitje, zëra, thonj, këmbë, dyer.** ...

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

Fjalia mund të ketë edhe më shumë se një kallëzues.

Mbylla portën dhe **ngjita** shkallët me vrap.

U ula pranë dritares, **hapa** librin dhe **fillova** të lexoj.

Pasdarke **u afrova** te dritarja, **u përkula** lehtë dhe **e fika** dritën që **gjendej** në komodinën pranë saj.

2. Shkruani nga dy fjali ku do të përdorni më shumë se një kryefjalë ose më shumë se një kallëzues!

1. _____.

2. _____.

1. _____.

2. _____.

Mbani në mend!

Kryefjalë mund të jetë edhe çdo pjesë tjeter e ligjëratës: **një mbiemër, një mbiemër foljor** ose **një numëror**:

I mençuri nuk ngutet.

Ngjyra e qiellit është **e kaltra**.

E drejta fiton çdo herë.

Kush erdhi **i pari**?

I pari që u dërgua në spital ishte **i lënduari**.

Ai ishte **njëshi i shkollës**

Mbani në mend!

Kallëzuesi mund të jetë dy llojesh: **foljor** kur shprehet me **një folje** dhe **emëror** – kur shprehet me **një emër**:

Mësova vjershën para të tjerve.
Atë ditë **u hidhërua** shumë çuni i dajës.
Sa e bukur, aq e mençur ishte vajza që erdhi.
Pamja nuk ishte as **e panjohur** dhe as **e bukur për të biseduar rrëth saj.**

Vini re!

Ndonjëherë fjalia ka vetëm një kryefjalë ose vetëm një kallëzues. Këto fjali quhen mungesore.

Natë e kthjellët. Hëna e plotë. Vetëtin. Mesnatë. Ç'shqetësim! Luftë! Rigon.

Ushtrime

1. Shkruani në fletoren tuaj ose në një fletë dy fjali që kanë kryefjalën **emër, dy fjali me kryefjalën **përemër** dhe dy fjali me kryefjalën **mbiemër**!**

2. Shkruani në fletoren tuaj ose në një fletë dy fjali që kanë kallëzuesin **emër dhe dy fjali me kallëzuesin **folje**!**

3. Shkruani në fletoren tuaj ose në një fletë gjashtë fjali mungesore – tri me vetëm kryefjalën dhe tri me vetëm kallëzuesin.

4. Në fjalitë në vijim përdalloni kryefjalën **emër, kryefjalën **përemër** dhe kryefjalën **mbiemër** duke i shënuar poshtë tyre.**

- a) **Rina** ka sy të kafenjtë.
- b) I vogli i nënës sa mirë këndon!
- c) Atë ditë ajo fluturonte nga gjëzimi.
- d) **E majta** nuk i punon mirë.
- e) Ne u mësuam me zhurmën e tyre.
- f) Qyteti shtrihej midis dy lumenjve.
- g) Të lumturit nuk e ndalnin këngën.
- h) Vëllezërit ngjanin shumë mes vete.
- i) **Ju** duhet të shkoni patjetër në punë.

5. Në tekstin në vijim përdalloni kallëzuesin **emër dhe kallëzuesin **folje** duke i ngjyrosur me ngjyrat e poshtëshënuara:**

- a) Atje tej **ngrihej** shtëpia e gjyshërve të mi.
- b) Fjala e saj kishte peshë të madhe.
- c) Në javën që vjen do të nisem për në Gjirokastër.
- d) **Të paktë** ishin ata që erdhën në shfaqje.
- e) Bukëpjekësi shiti gjithë bukët që kishte planifikuar.
- f) ky ishte një rast i veçantë për mua.

GJYMTYRËT E DYZA TË FJALISË

PËRCAKTORËT

Fjalia ka, pos kryefjalës dhe kallëzuesit, edhe gjymtyrë jo kryesore të cilat quhen gjymtyrë të dyta ose gjymtyrë plotësuese të fjalisë. Ato përplotësojnë nga ana kuptimore dhe strukturore gjymtyrët kryesore të fjalisë – **kryefjalën** dhe **kallëzuesin**.

Vajza u ngrit në njërin bërryl dhe **vështroi** me sytë e bukur dhe kureshtarë gjithçka kishte pérreth.

Fjalët e pangjyrosura - **në, njërin, bërryl, dhe, me, sytë, e bukur, dhe, kureshtarë, gjithçka, kishte, pérreth**, në fjalinë e mësipërme, janë **gjymtyrë të dyta** të fjalisë.

Disa nga këto gjymtyrë tregojnë ku bie veprimi i foljes, disa plotësojnë kuptimin e foljeve, disa përcaktojnë kuptimin e emrave a të përemrave.

Gjymtyrët e dyta të fjalisë, pra, janë tri llojesh:

1. përcaktorë
2. kundrina,
3. rrethanorë.

* * * * *

Ç'janë përcaktorët?

Përcaktorët janë gjymtyrë të dyta të fjalisë që përcaktojnë kuptimin e emrave e të përemrave.

Në fjali ata zakonisht janë **emra e mbiemra** të një rase, **emra të rasave gjinore** e **rrjedhore** ose janë **emra me parafjalë**.

Ndër përcaktorët dallojmë këto lloje fjalësh:

- përcaktorin,
- ndajshtimin, dhe
- përcaktorin kallëzuesor

Lexojmë tekstin:

Në qytet erdhëm **me tren**. Së pari na ra në sy **një urë e moçme**. Kaluam **lumin e rrëmbyeshëm** dhe sakaq u gjendem në pjesën tjetër të qytetit. Qyteti kishte një **bukuri të rrallë**. U mahnitëm së tepërmi. Ajo që na pëlqeu fort ishin **parget e bleruara** dhe muzeu i qytetit i pasur **me objekte e gjësende** **tepër të çmueshme**.

Fjalët e ngjyrosura me të kuqe (ne) **me tren**, (urë) **e moçme**, (lumin) **e rrëmbyeshëm**, (bukuri) **të rrallë**, (parqet) **e bleruara**, (objekte e gjësende) **tepër të çmueshme** quhen **përcaktorë**, sepse përcaktojnë, siç shihet në tekst, kuptimet e emrave e të përemrave - urë, lumë, bukuri, parqe, objekte e gjësende, ne.

Mbani në mend!

Përcaktori lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë **me emrin**. Përcaktori mund të jetë një **mbiemër** (i nyjshëm ose i panyjshëm) – *i kuq, e majtë, shkëlqyese, e drejtë, frikacak, një përemër përcaktues* (dëftor, pronor, i pakufishëm, etj.) – *këto (shtëpi), im (qeni), të mia (këpucët), të këtilla (mendimet), gjithë (qytetin).*

1. Rrezet **shkëlqyese** të diellit binin mbi flokët e saj **të artë**.
2. Rruga që çon te shkolla ime e baletit është **e drejtë** dhe **e gjerë**.
3. **Gjithë** Kosova po festonte në ditën e Pavarësisë.
4. Edhe ata shprehen kundërshtime të këtilla.
5. Ëndrrat e **tua janë tepër të guximshme**.
6. Librat **fantastikë** i pëlqejnë **tim** vëllai.

Ushtrojmë!

1. Si quhen përcaktorët në gjuhën e mjedisit ku jeton ti? _____

2. Sajoni në fletoren tuaj ose në një fletë 6 fjali me përcaktorët: **kashte** (kapele), **kërçove** (mollë), **të vjetra** (stoli), **të gjera** (fusha), **qortuese** (fjalë), **guximtare** (vajzë):

3. Sajoni në fletoren tuaj ose në një fletë 6 fjali me përcaktorët – mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm: **i vogël, i bardhë, besnik**, dhe me mbiemrat përcaktorë - pronor, i pakufishëm: **i saj, tonat, mbarë**:

4. Lexoni tekstin në vijim dhe përdalloni/nënvizoni përcaktorët:

Hana është **syzezë**, vetullzezë, flokëzë dhe sytë e saj, vetullat e saj dhe flokët e saj të zinj shquhen aq më shumë, sepse faqet e saj janë shumë të bardha. Atje ku është rritur, do të më tregojë më vonë, gjithmonë i kanë thënë e bardhë si bora! ...

E ka qeshjen e bukur, më të bukur se të mërkurën në mbrëmje, në faqe i bëhen quka, rreth syve tri rrudha të holla të mezidukshme...

Rexhep Qosja «Një dashuri dhe shtatë faje»

5. Sajoni një ese me titullin “**Një vizitë në Atdhe**”, me të paktën 8 rreshta, ku do përdorësh dhjetë përcaktorë!

NDAJSHTIMI

Mbani në mend!

Ndajshimi është një lloj përcaktori që shoqëron emrin a përemrin. Ai shënon të njëjtin frymor, send a dukuri që shënon emri dhe gjendet në të njëjtë rasë apo trajtë shquarsie sikur emri.

Unë luaj futboll në **ekipin** "Shkodra".

Lira rregullon dhëmbët te **dentisti** Ilir.

Shkrimtari Fan Noli ka jetuar edhe në Amerikë.

E takova **profesor** Arbrin.

Busti i **kryetrit** Skënderbe zbukuron shkollën tonë.

Duhet ta dimë se:

- **ndajshimin e gjejmë** të përdoret më së shpeshti në rasën emërore të pashquar:

Gjyshe Drita kishte gatuar bakllavanë e saj.

Të gjithë bashkë shkuam te **peshkatar** Jani.

Ne, të vegjlit e lagjes, u treguan shumë të zot në ruajtjen e mjedisit.

- **ndajshimi sqaron shpesh, edhe kuptimin e përemrit a të në fjale tjetër.**

Kjo, trimja e lagjes, u hodh e para në lumë.

Me ne erdhì **ai**, i vyeshmi i lagjes, për të rregulluar fushën e tenisit.

E jona, tezja Ilire, erdhì me binjakët e saj të bukur.

Mbani në mend!

Ndajshimi shprehet me emra të përgjithshëm që tregojnë **profesion** (mjek, mësues, balerinë, etj.) **titull** (profesor, akademik), **gradë** (gjeneral, toger, admirali, etj.), **pozitë politike, shoqërore** (kryetar, ambasador, drejtor, shef etj.), **raporte farefisnie** (gjyshe, nënë, teze, axhë etj.).

Ky lloj i ndajshimit qëndron para emrit: **mjeke** Bardha, **profesor** Genci, **gjeneral** Agimi, **gjyshe** Lumja etj.

Në rastet kur qëndron prapa emrit, ndajshimi shpreh një emër të përveçëm ose një emër të përgjithshëm: **vendi** (plazhi **Mali i Robit**, qyteti i minatorëve **Mitrovica** etj.) muaji (muaji **korrik**), titull vepre, filmi, gazete, institucioni (teatri "Dodona", vepra "Këngët e Milosaos", opera shqiptare "Delina" etj.)

Detyra

1. Sajoni në fletoren tuaj ose në një fletë **4 fjali ku do të përdorni** **ndajshimin**.

2. Sajoni një ese me **5-8 rreshta** ku do të përdorni disa **ndajshime** të vendosura para e pas emrave.

KUNDRINORI

Mbani në mend!

Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë, që tregon ku bie veprimi i foljes. Kundrinori varet, pra, nga folja dhe vihet në rasën që e kërkon gjymtyra prej së cilës varet.

Lexojmë fjalitë:

Blerta e mori **fletoren e detyrave**.

Fëmijëve u shpërndanë dhurata.

Shiu lagu me shpejtësi **tokën**.

A do të hani **me ne**?

Nga bardhësia e borës u ndriçua edhe qielli.

Beni e do shumë **lojën e futbollit**.

Fjalët e ngjyrosura me të kuqe **fletoren e detyrave, fëmijëve, tokën** (lagu), **me ne** (hani), **nga bardhësia e borës** (u ndriçua), **lojën e futbollit** (e do) quhen **kundrinorë**.

Ushtrojmë!

1. Si quhet kundrinori në gjuhën e mjedisit ku jeton ti? _____

2. Lexojmë bashkërisht tekstin në vijim duke përdalluar/nënvizuar kundrinorët.

Edhe sot qeshim **me èndrrën** e Borës sa herë kujtojmë atë kohë, kur ajo pa èndrrën e parë. Ju e mbani mend èndrrën e parë? Unë, për shembull nuk e mbaj mend fare. Po èndrrën e parë të Borës e kujtoj mirë se e pa natën dhe e kërkoi përsëri ditën.

Po, po, e kërkonte me tërë mend. Qante e përplaste këmbët dhe thërriste sa tundej shtëpia.

Nasho Jorgaqi «Mimoza llastica»

3. Plotësoni fjalitë me fjalët përkatëse – kundrinorët: **me çantën në dorë, dorezën e derës, èmbëlsirën, tekstin, me punën e bërë**.

1. Atë ditë Blerta i kërkoi gjyshes të gatuante **èmbëlsirën** që donte ajo.
2. _____ i pari erdhi Genti.
3. Ari zuri me shpejtësi _____.
4. _____ ju e merituat çmimin.
5. Mësuesi lexoi _____, kurse ne u bëmë sy e vesh.

Mbani në mend!

Kundrinori sipas kuptimi dhe formës së shprehjes mund të jetë: kundrinor i drejtë dhe kundrinor i zhdrejtë.

KUNDRINORI I DREJTË

Vini re fjalët e ngjyrosura me të kuqe në fjalitë në vijim:

1. Unë bleva **ushqimin** e zogjve.
2. Gjyshi rregulloi **syzet e tij**.
3. Babai e nëna po rregullojnë **kopshtin**.
4. Leka i vogël ushqeu **kalin**.
5. Lena vuri **kapelën** se po binte shi.
6. **Fshatin** e përfshiu një mot i ndryshueshëm.

Fjalët e ngjyrosura me të kuqe quhen **kundrinorë të drejtë**.

Mbani në mend!

Kundrinori i drejtë tregon objektin ku bie veprimi i shprehur nga folja. Ky objekt mund të jetë frymor ose jofrymor. Kundrinori i drejtë gjendet me pyetjet: **kë, cili, cilën**. Fjala që paraqet kundrinori i drejtë është më së shpeshti **emër** ose përemër në **rasën kallëzore**.

Lexojmë tekstin në vijim duke shënuar me të kuqe kundrinorin e drejtë!

Bora nuk foli, mori **gjyshen** për dore dhe e çoi në dhomën ku flinte.

-Ja këtu ishin, këtu. – tha vajza gjithë inat.

-Po cilat moj Borë, më thuaj?

Prapë Bora s’iu përgjigj pyetjeve të gjyshes, po zuri të kërkonte nëpër krevat. Ngriti dyshekun, lëvizi jastëkun, tërhoqi jorganin. U shtri pastaj poshtë krevatit. U ngrit dhe kontrolloi dollapin e rrobave.

Nasho Jorgaqi «Mimoza llastica»

Mbani në mend!

Kundrinori i drejtë është plotës kryesor i fjalisë. Ai nuk mund të hiqet nga fjalia sepse humb kuptimi i saj.

• •

Ushtrojmë!

1. Lidhni me shigjetë fjalitë me kundrinorin përkatës!

Nëna ime nget	fushën
Rrezet e diellit ndriçuan	gjuhën
Ajo i do shumë	dyshemenë
Rina pastroi mirë	veturën
Ata mësuan lehtë	përrallat

2. Vendosni në vendet e zbrazëta kryefjalën dhe kundrinën e drejtë!

Ari theu xamin

_____ mbuloi _____ kënduam _____

_____ vizatove _____ përgatiti _____

_____ ushqeu _____ kaluat _____

3. Detyrë shtëpie: Thurni pesë fjali me kundrinorin e drejtë!

KUNDRINORI I ZHDREJTË

Lexojmë fjalitë!

- | | |
|---------------------------------------|--|
| Ajo kapelë është e gjyshit . | Unë dola e dyta në garë . |
| Era është mbesa e saj . | Prindërit e tyre erdhën me aeroplan . |
| Shtëpia atje është e Drinit . | Pas tij dolën të gjithë. |
| Rina i shkroi shoqes . | Zogu fluturoi nga frika . |
| Batanija është e vajzave . | Lira po shëtiste me të ëmën. |
| Unë i hodha vështrim qytetit . | Më mori malli për detin . |

Fjalët që janë shënuar në fjalitë e mësipërme **me të kuqe** janë **kundrinorë të zhdrejtë pa parafjalë**.

Fjalët që janë shënuar në fjalitë e mësipërme **me të gjelbër** janë **kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë**.

Mbani në mend!

Edhe kundrinori i zhdrejtë është gjymtyrë plotësuese e fjalisë që plotëson kuptimin e kallëzuesit. Kundrinori i zhdrejtë mund të jetë me parafjalë dhe pa parafjalë.

Lexojmë tekstin në vijim duke nënvizuar me **të kuqe kundrinorët e zhdrejtë me e pa parafjalë!**

Pastaj i erdhi radha **djalit të tretë** për të bërë roje **poshtë pemës**. Mbreti nuk i besonte shumë djalit të tij të vogël dhe e pati të vështirë t'i caktonte këtë detyrë....

Djali i vogël u kap pas bishtit dhe bashkë me dhelprën përshkoi lumenj, kodra të tëra sa hap e mbyll sytë. Dhe përsëri flokët e djalit ishin lagur plotësisht.

Më fund mbërritën përpara kështjellës, djali i vogël hyri në bodrumin ku qëndronte kali.

Vëllezërit Grim «Na ishte njëherë»

Mbani në mend!

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë është gjithmonë në rasën dhanore dhe e gjejmë me pyetjet: **kujt?**, **cilit?**, **cilës?**, **cilëve?**, **cilave?** etj. Ai paraqitet gjithmonë me trajtë të shkurtër të përemrit vетор në rasën dhanore: (mua) më, (ty) të, (atij) i, (asaj) e, (neve) na, (juve) ju, (atyre) u.

Ushtrojmë!

1. Lidh me shigjetë fjalitë me kundrinorin e zhdrojtë pa parafjalë!

Zana i erdhi në ndihmë	babit
Blerta ia dha lajmin	shoqes
Kordelja është e	shtëpisë
Librin ia dhashë	Dritonit
Ato fjalë thuaja	kukullës
Ato janë dritat e	mësueses

2. Vendosni në vendet e zbrazëta kryefjalën dhe kundrinën e zhdrojtë pa parafjalë!

Libri i përket Agimit

_____ ia dha _____ i tregonte _____
_____ ia morën _____ ia fali _____
_____ i hoqën _____ i këndoi _____

Mbani në mend!

Kundrinori i zhdrojtë **pa parafjalë** është, po kështu, plotës kryesor i fjalisë dhe nuk mund të hiqet sepse humb kuptimi i fjalisë.

Provo të heqësh kundrinorin e zhdrojtë pa parafjalë nga fjalitë e mësipërme dhe do të shohësh se kështu lëndohet kuptimi i fjalisë. P.sh.: Libri i përket. Djemtë ia morën.

Mbani në mend!

Kundrinori i zhdrojtë **me parafjalë** në fjali paraqitet si **emër, përemër** ose **grup emëror** në **rasën emërore, në kallëzore** e në rrjedhore, i shoqëruar gjithmonë me parafjalë. Edhe kundrinori i zhdrojtë me parafjalë është gjymtyrë plotësuese e fjalisë, ndërsa gjendet me pyetjet: **me kë, për kë, për cilin a cilën, nga kush, prej kujt, prej cilit a cilës**, etj.

Ushtrojmë!

1. Lidh me shigjetë fjalitë me kundrinorin e zhdrojtë me parafjalë!

Hana erdhi	për filmin
Ata flisnin	pas saj
Ajo po vraponte	me gjyshin

Rrugët u përmbytën nga shiu (i madh)
Ari kishte rënë në mendime
Unë vendosa librat mbi tryezë

2. Vendosni në vendet e zbrazëta kryefjalët (vogëlushi, topi, ftesat, kori, vajza, ne**) dhe kundrinat e zhdrojta me parafjalë (**nën urë, nga bubullima, drejt hekurudhës, për në bjeshkë, me zemër, përmes postës!**)!**

Ata u zunë rrreth garës.

_____ u nisëm _____ u rrokullis _____
_____ u zgjua _____ u nis _____
_____ erdhën _____ i këndoi _____

RRETHANORI

Rrethanori është ajo gjymtyrë e fjalisë, e cila tregon rrrethanat e kryerjes së një veprimi. Këto rrrethana lidhen me kohën, vendin, mënyrën, sasinë, shkakun etj. Rrethanorin në fjali e gjejmë me pyetjet: **kur?, ku?, nga?, si?, sa?, përse?** etj. Rrethanorët, pra, tregojnë **vend, kohë, sasi, mënyrë**.

Lexojmë tekstin duke përdorur fjalët pyetës kur?, ku?, nga?, si?, sa?, përse?

Prandaj Suzana gjithmonë priste **me padurim** ardhjen time. Ajo thoshte se mërzitej **shumë midis të mëdhenjve**, Ajo mërzitej **në shtëpi** duke qëndisur, mërzitej **tek çesma** dhe mërzitej kur hante bukë. Ajo mërzitej **në mesditë**, mërzitej **në mbrëmje**, mërzitej bile edhe **në mëngjes**. Me një fjalë mërzitej **jashtëzakonisht**. Këtë fjalë ajo e pëlqente shumë dhe e nxirte nga goja me një kujdes të veçantë, sikur kishte frikë se mos e lëndonte pa dashur me dhëmbë apo me gujhë.

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

Ushtrojmë!

1. Vendosni në vendet e zbrazëta ndajfoljet: **mbrëmë**, **drejt**, **në qendër** të qytetit, **mrekullueshiëm**, **rrëmbyeshëm**, **përmes** fshatit, **papritmas**, **pasdite**, **shpejt**.

1. Ne u nisëm _____ kodrinës _____.

2. Lumi që kalonte _____ ishte i _____.

3. _____ erdhi Valmiri dhe hyri _____ në dhomë e vet.

4. _____ ajo kërceu _____.

5. _____ eca deri në qendër të qytetit.

Mbani në mend!

Rrethanori mund të hiqet nga fjalia pa u prishur kuptimi i saj.

Ushtrojmë bashkërisht!

1. Nën vizioni në fjalët vijuese rrëthanorët, pastaj hiqini dhe shikoni si tingëllojnë fjalitë pa to. A është prishur kuptimi i fjalive; si është ndryshuar kuptimi i fjalisë?

1. Babai erdhi befas.
2. Mëngjeseve dilte buzë rrugës dhe priste nëse vinte kush.
3. Ec djathtas.
4. I ra rrugës rrotull
5. Vera mbërriti padiktueshëm.

Mbani në mend!

Sipas rrëthanës që tregojnë ndajfoljet mund të dallojmë:

1. **rrethanorë vendi** (tregojnë vend)
2. **rrethanorë kohe** (tregojnë kohë)
3. **rrethanorë sasie** (tregojnë sasi)
4. **rrethanorë mënyre** (tregojnë mënyrë)
5. **rrethanorë shkaku** (tregojnë shkak)
6. **rrethanorë qëllimi** (tregojnë qëllim)

Gjeni ndajfolje sipas shembujve të parë!

Rrethanorë vendi: **në rrugë**, _____.

Rrethanorë kohe: **vjet**, _____.

Rrethanorë sasie: **disa herë**, _____.

Rrethanorë mënyre: **pa dashur**, _____.

Rrethanorë shkaku: **për të ecur**, _____.

Rrethanorë qëllimi: **nga frika**, _____.

Ushtrojmë!

1. Në tekstin vijues gjeni e ngjyrosni me të kuqe rrethanorët e vendit e të kohës:

Jashtë, në rrugë, papritur, zuri të frynte një erë. (...) Në fillim era sikur luante valle me gjethet e letrat poshtë në trotuar, ngrinte pluhurin përpjetë, por pastaj e shtoi shpejtësinë dhe u rrit, filloi të përkulte drurët e pemëve dhe të përplaste dyert e dritaret e hapura. U bë një zhurmë e rrëmujë e madhe dhe herë pas here era fishkëllente, sikur i frynte një bilbili të prishur.

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

2. Lidhni me shigjetë fjalitë me rrethanorët përkatës!

Ajo ishte e lumtur	mbi lulet.
Ari erdhi	për në det.
Bleta fluturonte	në mëngjes.
Fëmijët erdhën në shkollë	atëherë.
Lekë, eja	nga Kosova.
Zana e Lira u nisën	mbrëmjeve.
Gjyshja na tregonte përralla	më shpejt.

3. Në tekstin vijues gjeni e ngjyrosni me të kuqe rrethanorët e mënyrës dhe të sasisë!

Ky ishte një qytet i çuditshëm, që dukej sikur kishte dalë në lugine **papritur** një natë dimri si në qenie parahistorike (...). Gjithçka në këtë qytet ishte e vjetër dhe e gurtë, duke filluar nga rrugët dhe çezmat e gjer te çatitë e shtëpive të mëdha shekullore që ishin të mbuluara me pllaka guri ngjyrë gri, të cilat u ngjanin luspave gjigante... **Shumë** gjëra këtu ishin të pabesueshme dhe shumë gjera ishin si në èndërr.... Stera ishte shumë e madhe... Ata të tre ishin të shqetësuar e nuk më vunë re.

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

4. Në tekstin vijues gjeni e ngjyrosni me të kuqe rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit:

Gjithë pasditen njerëzit dilnin nëpër dritare e ballkone **për të parë** se mos po dukej bateria kundërajrore. ... Gdhiu e hëna. Për çudi atë ditë anglezët nuk erdhën për të bombarduar... Por të martën ata erdhën. Sirena, si gjithmonë, ngriti deri në qiell kujën e saj. Njerëzit bënë sikur harruan padurimin që treguan një ditë më parë për ardhjen e avionëve dhe u sulën tatëpjetë shkallëve të kubesë...

Ismail Kadare «Kronikë në gur»

L E K S I K O L O G J A

Fjalëformimi

Të rikujtojmë ato që kemi mësuar më herët

Fjala është njësia kryesore e një gjuhe. Ajo ka **formë** dhe **kuptim**.

Kemi mësuar gjithashtu se:

- fjala gjatë përdorimit merr forma të ndryshme, por ndryshon vetëm një pjesë e fjalës;
 - përbërësit e fjalës janë: **rrënja, mbaresa, parashtesa** dhe **prapashtesa**;
 - pjesa e fjalës që nuk mund të ndahet në pjesë përbërëse dhe që përmban kuptimin kryesor quhet **rrënje** e fjalës: **njeri, shtëpi, flas**;
 - pjesa e ndryshueshme e fjalës quhet **mbaresë** e fjalës: (njeri)**un**, (shtëpi)**né**, **flas(im)** Këto mbaresa te emrat e mbiemrat tregojnë gjininë, numrin a rasën, te foljet vetën, kohën etj.
 - shtesat që i ngjiten rrënjës quhen **ndajshtesa** – shtesa para rrënjës quhet **parashtesë**, (p.sh. *përqëndroj*) kurse shtesa që i ngjitet prapa **prapashtesë** (p.sh. *ushtarak*).
 - me ndajshtesa krijohen **fjalë të reja**, me formë e kuptim.

Mbani në mend

Fjalët e reja formohen mbi bazën e rrënjës. Fjalët që kanë rrënje të përbashkët, formojnë një familje fjalësh.

Ushtrojmë!

Lexojmë tekstin në vijim dhe përdallojmë fjalët e thjeshta (pa parashtesa e prapashtesa) dhe fjalët me parashtesa dhe prapashtesa!

Kur tisi i muzgut e **terratis fushëtirën**, nis edhe ankthi im. Çdo hije **kalimtari** që duket larg, çdo hije tjetër e **shkaktuar** prej territ, prej **ndriçimit** të hënës, apo prej **ndonjë gjallese**, nis e ma kall datën. ...

Sado e **pabesueshme** të **tingëllojë** kjo, përfat të keq është e vërtetë. Ndërsa tmerri i tyre është **përqëndruar** mbi **qenien** time ... Dhe nuk ka gjë më të **llahtarshme** se ankthi me burim të **panjohur** ...

Ismail Kadare «Ëndërr mashtruese»

Të mësojmë !

Në gjuhën shqipe, sipas **mënyrës së ndërtimit**, fjalët ndahen në:

- **fjalë të parme**, fjalët bazë që nuk vijnë prej fjalëve të tjera, që nuk kanë ndajshesa: *qiell, djalë, fushë, kokë, dritë* etj.
- **fjalë të prejardhura**, fjalëtqë kanë ndajshesa – parapashtesa e prapashtesa: *mësim, lyerje, ndriçimtar, pishnajë, pabesi, besimtar, duresë*, etj.
- **fjalë të përbëra**, fjalët që formohen nga dy e më shumë tema ose fjalë të parme: *dorëzanë, marrëveshje, fjalëpakët, fatbardhë, kryemadh, gjetherënës*, etj.
- **fjalë të përngjitura**, fjalë që formohen nga dy ose më shumë fjalë: *gjithandej, përkëtej, teposhtë, prapëseprapë, megjithatë, lamtumira*, etj.

1. Plotëso grafikonin me fjalët sipas udhëzimit!

fjalë të parme	fj. të prejardhura	fj. të përbëra	fj. të përngjitura

2. Zbërthe fjalët në vijim në përbërësit e tyre:

fjala	parashtesa	rrënja	prapashtesa	mbaresa
ripunoj	ri	pun(ë)	o	j
përkrenare				
trimëreshë				
kujtoj				
ëndërrimtar				
dorëmbarë				

Mësojmë!

Fjalët sipas mënyrës së formimit, në gjuhë shqipe, ndahen në:

- fjalë të prejardhura **me ndajshtesa**,
- fjalë të prejardhura **pa ndajshtesa**,
- fjalë të prejardhura të përbëra e të përngjitura.

1. Fjalët e prejardhura **me ndajshtesa** janë tri llojesh:

- a. fjalë **me parashtesa** – *përdor, përshëndet, zbardh, mbishtresë, nënshkruaj, padje, shthur, moskujdes, rinjohje, i çrregullt, etj.;*
- b. fjalë **me prapashtesa** – *rrugor, valltar, miqësor, mësim, qesharak, nxënës, koprrac, djathtas, fshehurazi, dalje, tinëzisht, frikshëm, etj.*
- c. fjalë **me parashtesa e me prapashtesa** – *përmalloj, zgjerim, pagjumësi, i përditshëm, shfletoj, përshtatje, nëndetëse, etj.*

Detyra:

1. Shkruani fjalë të formuara mbi bazën e fjalëve-tema: **qytet, punoj, drejt, vlerë, palos, rrugë.**
2. Formoni fjalë me parashtesat e prapashtesa **nën-, pa-, sh-, ç-, z-, -tar, -si** dhe shkruani në fletoret tuaja!

LEKSIKU DHE SEMANTIKA

Njësitë themelore të gjuhës janë, siç e pamë më herët: **fonema, morfema, fjala, togjalëshi** dhe **fjalia**. Fjala ka **formë** dhe **përbajtje**.

Kështu fjala **shtëpi** nga ana leksikore do të thotë «ndërtesë për të banuar, banesë», kurse nga ana gramatikore është emër i gjinisë femërore, numri njëjës, trajta e pashquar, rasa emërore.

Mësojmë!

Përbajtja e fjalës është leksiko-gramatikore, sepse **ka kuptim leksikor** dhe **kuptim gramatikor**.

Kuptimi leksikor i fjalës studiohet në **leksikologji**, kurse kuptimi gramatikor i saj në **gramatikë**.

Mbani në mend!

Leksikologjia është degë e gjuhësisë që studion leksikun e një gjuhe, pra tërësinë e fjälëve të një gjuhe.

Semantika është degë e gjuhësisë që studion kuptimin a përbajtjen e fjälëve.

Çdo fjälë ka **vlerë kuptimore**. Disa fjälë kanë vetëm një kuptim, disa të tjera kanë dy a më shumë kuptime. Kështu fjala **qafë** ka kuptimin e «pjesës që bashkon kokën me trupin e njeriut dhe të kafshëve, zverku». Por, fjala **qafë** ka edhe kuptimin e «pjesës së ngushtë dhe të zgjatur të një ene, të një vegle», qafa e shishes; pastaj ka kuptimin e një «vendi më të ulët në kurrizin e malit a të kodrës, nëpër të cilën kalon udha», p.sh.: Qafa e Thanës në kufirin maqedonaso-shqiptar, Qafa e Kërrabës afér Elbasanit, etj. Kjo fjälë ka edhe kuptime të tjera.

Fjala ka **aftësi fjalëformuese**, sepse mund të krijohet fjälë të reja mbi bazën e çdo fjale: *ski, skijim, skitar, skitari*, etj.

Fjala ka **vlerë sintagmatike** e kjo do të thotë se ka aftësi të lidhet me çdo fjälë tjetër:

Kështu fjala **dorë** ka ndërtuar numër të madh lidhjesh si këto: *dorë e djathtë, e ka në dorë, i dha dorë, prek me dorë, ia la në dorë, dorë e fortë, dorë e ligë*, etj.

Fjala ka edhe **kuptim figurativ**, që do të thotë se ka kuptim jo të drejtpërdrejtë. Na ka rënë të dëgjojmë shpesh të thuhet: *e hoqi qafe* që do të thotë e «largoi», ose *ia dredh qafën* që ka kuptimin e «qorton».

Ushtrojmë!

1. A dini ju ndonjë rast tjetër që një fjalë a shprehje të ketë më shumë kuptime? Çka mendoni për shprehjet: ai e ka syrin shqiponjë, ajo është **dhelpër**, frynte nga **gryka** e malit, bie bora **flokë-flokë**, etj. A dini edhe shembuj të tillë nga gjuha e vendit ku jetoni?

Provojmë dijet tonë!

- Ç'kuptojmë me fjalët **leksikologji** e **semantikë**?
- Ç'kuptojmë me shprehjet **kuptim leksikor** e **kuptim gramatikor**?
- Ç'kuptojmë me shprehjen **kuptim figurativ**?
- Çdo të thotë **aftësi fjalëformuese** ?
- Po **vlerë sintagmatike**?

SINONIMET

Lexojmë tekstin duke u përqëndruar te fjalët me ngjyrë të kuqe!

Po Vitës së **dëshpëruar**, **kokulur** e **zemërthyer** asgjë nuk i bënte përshtypje. Aty pak më përpara, çdo **ferrë**, çdo **marinë**, çdo **rrënëzë zhuke**, që mund të ishte **strofull** breshke a gjarpëri, i dukej sikur ishte **folezë** e lumturisë së saj. Tani çdo blacë bërrylaku, çdo **drizë**, çdo **ferrë**, çdo **zhukë**, çdo **murriz** që takonte në udhë mund të ishte **fole** mëlljenje apo larashi, i dukej **çerdhe dëshpërimi** e **zie**.

Jakov Xoxa «Lumi i vdekur»

Çka keni vërejtur? Çka kanë të përbashkët **fjalët**:

dëshpëruar - kokulur - zemërthyer
ferrë - marinë - drizë - zhukë - murriz
fole - folezë - çerdhe - strofull
dëshpërim - zie

Këto fjalët nga ana kuptimore janë të afërt me vete. Në gjuhë ato emërtohen me emrin **sinonime**.

Mbani në mend!

Fjalët që kanë përbërje të ndryshme tingullore, por kuptim të njëjtë ose të afërt quhen **sinonime**.

Gjuha shqipe është e pasur me sinonime si këto: *vajzë-çikë, fshat-katund, forcë-fuqi, krye-kokë, rrugë-udhë, pikëllim-hidhërim, shikoj-vështroj-këqyr-shoh-sodis, kaloj-kapërcej*, etj.

Lexoni tekstin në vijim duke nënvizuar sinonimet dhe më pas shkruani ato poshtë tekstit:

Ruani të mos digjet e përvëlohet Nafora nga demixhanat e panumërt me raki dhe kacekët e pafund me vaj, se, edhe po të digjet kasabaja e ngre prapë Naforaja; ndërsa po të digjet e shkrumboset Naforaja s'e ngre më dot kasabaja...

Jakov Xoxa «Lumi i vdekur»

Në gjuhë krijohen lidhje të ndryshme sinonimike. Më të rëndësishmet janë këto:

- fjalë të gjuhës standarde:** *gjithë-tërë; tash-tani; kokë-krye, hap-çel, kurriz-shpinë, mandej-pastaj; pas-prapa ; zvarritem-zhagitem; vapë-të nxehëtë*, etj.
- fjalë të gjuhës standarde – fjalë dialektore a krahinore:** *gjel-këndes-kokosh; ftoj-grish; qumësht-tambël; fqinj-komshi-gjiton; tjegull-qeramidhe, vapë-zheg*, etj.
- fjalë dialektore – fjalë dialektore:** *kaphsh-kokosh-knues; penxhere-prezore; garuzhdë-golare-pehar; kérkoj-ngjëroj (për provoj gjellën)*, etj.

4. fjalë krahinore – variante fonetike krahinore: *dhjamë-vjamë, ylber-dylber-liliver; felsigen-selvigen; kafshatë-kafshitë; vdes-des, dasmë-darsëm, përshesh-pshesh, etj.*

5. fjalë shqipe – fjalë e huaj: *përvojë-eksperiencë; kohë-vakt; orë-sahat; mjedis-ambient; gjuhësi-lingistikë, mjekësi-medicinë, florë-bimësi, faunë-shtazëri, etj.*

6. fjalë e gjuhës shqipe-fjalë e vjetruar: *polic-milic-xhandar; atdhe-vatan, mërgim-kurbet; ushtar-nizam; anije-xhemë ; fletore-defter, laps-kushum, gjykatës-kadi, etj.*

Vini re!

Nuk janë sinonime fjalët që krijohen mbi bazën e mohimit: *afër – jo larg, i lagur – jo i tharë, i mirë - jo i keq.*

Sinonimet mund të përdoren edhe në çifte fjalësh: *qaj e vajtoj, kopalla e dokrra, shtrydh e ndrydh, mallkoj e nëm, baltë e llucë, djeg e pjek, përzjej e ngatërroj, etj.*

Në gjuhën e letërsisë gjejmë shumë sinonime. Shumë nga ato janë sinonime vetëm në veprën letrare. Sinonimet e tillë quhen **rastësore** ose **kontekstuale** (**zhumhur – piskamë-vikamë – vërrimë – krismë – zhaurri – erë – poterë**). Ta shohim një shembull:

*Edhe u dha aty nji zhumbur,
Nji piskame, nji vikame
E nji erë, e nji poterë,
Vrrimë, e krisme, edhë zhaurri,
N' vend Ballkani, thue u turrshî.*

Gjergj Fishta "Lahuta e Malcis"

Detyra:

1. Gjeni sinonimet për fjalët në vijim:

afër -	mundohem -	inat -
kufi -	hajn -	kulm -
mazë -	të ftohtë -	bark -

2. Lexoni vargjet në vijim, gjeni dhe nënvízioni me të kuqe sinonimet:

*Se aj s' po kisht' tjeter zanát,
Veç pre e rip, e digj e piq:
Rrxo, rreno, e vendin flligj
Me mehmurë e me agallarë,
Qi 'i punë kta curr s' kan sjellë marë;
Veç rrähë m' shkop, e vár m' konop:
Vidh, robit, e tokët plaçkit:*

Gjergj Fishta «Lahuta e Malcis»

ANTONIMET

Lexojmë tekstin duke u përqendruar te fjalët me ngjyrë të kuqe!

Hynte dhe **dilte vjeshta**, e **zinte** dhe e **linte dimri**, **vinte** e **shkonte vera** dhe kumbara s'kujtohej të hapte gropën e të kërkonte rrëzë fiku.

Atij që po i merrej mendja nga fuqitë e verës dhe të ziftit që po rrokuilliseshin gjatë motit, një palë **tutje** e një palë **tëhu duke zbrazur** dhe **mbushur** hambarët e vaporëve dhe të maunave, që tundeshin si djepë gjigante, të lidhura **në të djathë** e **në të majtë** të motit.

Jakov Xoxa «Lumi i vdekur»

Çka keni vërejtur? Çka paraqesin çiftet e fjalëve:

hynte - dilte

i bardhë - i zi

zinte - hintee

tutje - tëhu

vinte - shkontakte

zbrazur - mbushur

dimër - verë

në të djathë - në të majtë

Këto fjalë nga ana kuptimore janë të kundërt mes vete. Në gjuhë ato emërtohen me emrin **antonime**.

Mbani në mend!

Fjalët e ndryshme me kuptim të kundërt quhen antonime.

Antonime kanë një numër i caktuar i fjalëve. Për shembull: **i mirë-i keq, i vogël-i madh, i afërt-i largët, poshtë-lart, ulem-ngrihem, natë-ditë, terr-dritë, dimër-verë, mbyll-hap, i butë-i fortë, i gjëzuar-i hidhëruar**, etj.

Ushtrime

Lexoni tekstin në vijim duke nënvizuar çiftet antonimike dhe më pas shkruani ato poshtë tekstit:

Mund të fryjë ditën në verë e të shfryjë natën në dimër, por diku, në zenitin e tyre era dhe tufani shtrohen e tulaten për t'ia filluar përsëri aty nga mbrëmja apo mëngjesi, kur thyhet dita apo nata ... Sa për datën, sot është shpejt për ta parë ai, kurse nesër do të jetë shumë vonë. ... Të pasurit e kripores rrinë lart kurse të varfërit poshtë...

Jakov Xoxa «Lumi i vdekur»

Të mësojmë!

Kundërvëniet kuptimore në gjuhë u përgjigjen kundërvënieve të koncepteve për sendet dhe dukuritë e realitetit. Kundërvëniet rreth nesh paraqiten edhe në gjuhë.

Sipas ndërtimit antonimet në gjuhën shqipe janë dy llojesh:

1. antonime – fjalë krejtë të ndryshme: *marr-jap, zgres-ngjitem, brenda-jashtë, këndeje-andej, bie-ngrihem, i ri-i vjetër, ftohtë-nxehtë, trim-frikacak*, etj.

2. antonime – fjalë të formuara me parashtesa me kuptim të kundërt: *ç-, sh-, zh-, s-, z-, mos-, pa-, jo-, anti-, kundër-, mbi-, nën-, etj.: lodhem-çlodhem, qep-shqep, vendos-zhvendos, dredh-zhdredh, kamje-skamje, sulm-kundërsulm, kujtesë-moskujtesë, i shkathët-i pashkathët, dije-padije, çmoj-nënçmoj, peshë-mbipeshë*, etj.

Duhet ta dini!

Ashtu sikur sinonimet, edhe antonimet janë një mjet i vlefshëm për shkrimtarin pët të arritur shprehësinë stilistike

Të shohim me ç'denduri i përdor shkrimtari Gjergj Fishta antonimet në veprën e tij «Nikolejda»:

*Si ma mirë, nuk ke pse pyet:
Ha e pi rri pështetë,
Shko e eja poshtë përpjetë,
Kryet matare, mendt kobure,
Barkun çark sa nji sy ure,
Veshë e mbathë për bukurin,
Me karroca e tevabi,
Me ba be se jam zotni.*

Ushtrim

1. Fjalëve të poshtëshënuara ua gjeni antonimet!

burrë _____ fushë _____ pleqëri _____
drejtë _____ te poshtë _____ thur _____
i fortë _____ i lehtë _____ fuqizoj _____
mbath _____ i ëmbël _____ çlodhem _____

2. Plotësoni fjalitë me antonimet e duhura:

Verës shkoj në det, kurse _____ në rri në shtëpi.

Ai qante, kurse ajo _____.

Ne duam _____, mirëpo duhet të shkojmë në punë.

Gjyshja hynte e _____ pa folur asnjë fjalë.

3. Shkruaj disa çifte antonimike në gjuhën e mjedisit ku jeton ti!

FJALËSI I GJUHËS SHQIPE DHE FJALËT E HUAJA

Po rikujtojmë!

Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Ajo është një degë e veçantë e **familjes gjuhësore indoевropiane**.

Mësojmë!

Gjuha shqipe përbëhet nga një pasuri e madhe mjetesh të shprehjes. Sipas burimit në leksikun e gjuhës shqipe dallojmë dy shtresa gjuhësore:

- **shtresa vetjake** që konsiderohet e burimit të saj që nga lashtësia e që përbën shtresë e përbashkët leksikore me gjuhët e tjera indoevropiane.

- **shtresa e huazuar**, ku përfshihen fjalët që kanë hyrë në shqipen nëpër shekuj.

Fjalë të shqipes **të burimit të hershëm indoevropian** janë p.sh.: *ari, atë, bir, i bardhë, motër, diell, ditë, natë, dem, djathë, dorë, drekë, elb, èndërr, mal, emër, kohë, gjarpër, mjegull, mjekërr, thaj, them, pi, pjek, mot, punë, i vogël, mirë, keq, shteg, ujk, unë, ti, ne, etj.*

Këto fjalë shënojnë nocione e koncepte me rëndësi jetësore: **sende e dukuri** të natyrës, **kafshë**, **emra farefisnie** etj.

Në të shumtën e herës ato janë rrënë të fjalëve, nga të cilat janë formuar deri sot numër shumë i madh i fjalëve në gjuhën shqipe. Sipas studiuesve të gjuhëve, ky numër i fjalëve të përbashkëta të gjuhëve indoevropiane shkon deri në **2000** sosh.

Mbani në mend!

Shtresa e hershme e leksikut indoevropian përbën bazën kryesore të leksikut të gjuhës shqipe.

Shtresë më të re e leksikut të shqipes e quajmë leksikun që përbëhet nga **fjalët e prejardhura e të përbëra** prej këtyre të parave.

Nga kjo shtresë po përmendim disa nga këto fjalë: **dimëror** (prej **dimër**), **ditor** (prej **ditë**), **diellor** (prej **diell**), **mirësi** (prej **mirë**), **bërje** (prej **bëj**), **drekoj** (prej **drekë**), **atëror** e **atësi** (prej **atë**), **bardhësi**, **bardhosh** (prej **bardhë**), **vegjeli** (prej **i vogël**), **punoj**, **punëtor**, **punishte** (prej **punë**), e kështu me radhë.

Fjalë të shqipes janë edhe fjalët e formuara prej **pasthirrmave** dhe **tingullimitimeve** si këto: **mërmërit, belbëzoj, mjaullitje, fëshfërimë, gurgullon, hingëllin, pëshpërit, rrufit, rrapëllimë, zukat, guguçe, çuçurit, çikit, dërdëllis** etj.

Si çdo gjuhë tjetër, edhe gjuha shqipe, ka mjaft **fjalë të huazuara ose fjalë të huaja:**

Cila është shtresa e huazuar e fjalëve në gjuhën shqipe? C'janë fjalët e huaja?

Huazim gjuhësor quajmë kur marrim një fjalë a shprehje prej një gjuhe tjetër.

Në çdo gjuhë hyjnë fjalë të huaja dhe kjo ndodh që nga kohët e hershme. Këto fjalë hyjnë në një gjuhë kur sjellin emërtime për ide e sende të reja. Por mjaft shpesh fjalë të ndryshme kalojnë prej një gjuhe në tjetrën edhe kur gjuha nuk ka nevojë për to. Këtë lëvizje të fjalëve prej një gjuhe në tjetrën e nxisin kontaktet e folësve të këtyre gjuhëve.

Huazimet në gjuhën shqipe kanë hyrë prej disa shekujsh. Përdallojmë shtresën e fjalëve të hershme **greke e latine**, pastaj shtresën **turke**, më vonë shtresën **sllave** dhe prej shekullit të kaluar kanë hyrë mjaft fjalë prej gjuhëve : **françese, angleze, italiiane, gjermane**.

Shumë fjalë të huaja që i kemi në gjuhën shqipe i gjejmë edhe pothuajse në të gjitha gjuhët e botës. Të tilla janë fjalët si këto: **gramatikë, gjeografi, sinonim, antonim, histori, adresë, republikë, telegraf, teatër** etj. Ato quhen **fjalë ndërkombëtare** dhe e kanë burimin te greqishtja e latinishtja e vjetër.

Po i përmendim sa për ilustrim disa nga fjalët që kemi marrë nga gjuhët e ndryshme:

- **fjalë greke:** laker, qershi, presh, pjepër, fis, flamur, oreks, i pastër, stolis etj.
- **fjalë latine:** fëmijë, flokë, fytyrë, gusht, këmbë, këngë, mjek, lepur, letër etj.
- **fjalë sllave:** gostit, fladit, çekiç, kovë, krahinë, grusht, kockë, porosit, prag etj.
- **fjalë turke:** çarçaf, xhevze, tepsi, kafe, inat, bakllava, top, çorape, baba, pazar etj.

Mbani në mend!

Fjalë të huaja hyjnë me të madhe sot në shqipen.

Fjalët që hyjnë sot në gjuhën shqipe janë të fushës së teknologjisë, ekonomisë, mjekësisë, tregtisë, kompjuterikës, muzikës, sportit, kulturës, artit, etj. Disa nga ato fjalë janë: **biznes, marketing, kompjuter, printer, ajfon, e-mail, hit, performansë**, etj. Pjesa dërmuese e tyre vjen nga **anglishtja**, e cila ka një ndikim shumë të fortë edhe mbi gjuhë të tjera.

Shumë nga fjalët e huaja nuk mund të zëvendësohen me fjalë të shqipes. Megjithatë, mjaft fjalë të huaja janë të zëvendësuara me ato shqipes, si fjala vjen këto: **kuvend** për **parlament, miratoj** për **aprovoj, mjedis** për **ambient, prirje** për **tendencë, pérurim** për **promovim** etj.

Përsërisim!

1. Kush e përbën bazën kryesore të leksikut të shqipes?
2. Cila është shtresa vetjake e leksikut të shqipes?
3. Cila është shtresa e huaj në leksikun e shqipes?
4. Pse hyjnë fjalët e huaja nga një gjuhë në tjetrën?

Detyrë

Bashkë me mësuesin/mësuesen ua gjeni zëvendësimin këtyre fjalëve të huaja me përgjegjëset shqipe duke i shkruar në listën e mëposhtme:

lokal _____ akumuloj _____ distance _____
final _____ medicine _____ okupoj _____
preciz _____ prezencë _____ perfekt _____
start _____ prezantoj _____ stabilitet _____
selektoj _____ spiker _____ maus _____

DREJTSHKRIM

Shkrimi i **ë**-së së patheksuar në pozita të ndryshme të fjalës

Tingulli **ë** gjendet në pozicione të ndryshme të fjalës: në **fillim**, **brenda** dhe në **fund** të fjalës.

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe ka përcaktuar disa rregulla të përdorimit të saj. Me disa nga këto rregulla do të njihemi në vijim:

1. ë-ja e patheksuar shkruhet në të gjitha fjalët e parme kur ajo gjendet në rrökjen e parë: *këpucë, mësim, këndo, thërras, lëkurë, bërryl, përrallë, sëmundje, ndërrim, kështu, dërrasë, gëzim, (të) këqija, kërcej, pëllumb, mënyrë, përemër, i këtillé, etj.*

2. ë-ja e patheksuar shkruhet në të gjitha fjalët e prejardhura që formohen nga një temë me -ë, prapashtesat e të cilave fillojnë me bashkëtingëllore: *gjuhësi, botëror, punëtor, këngëtar, copëtoj, bardhësi, lehtësi, frikësor, datëlindje, frymëmarrje, jetëgjatë, mirëmëngjesi, furrtar, shpejtësi, tokësor, etj.*

3. ë-ja e patheksuar shkruhet edhe te fjalët e prejardhura që përfundojnë me bashkëtingëllore, por që kanë një ndërtim të ngjashëm me fjalët e sipërpëmendura: *madhësi, lajmërim, mbretëri, miqësor, fshatarësi, shëndetësi, mjekësi, trimëri, shtetëror, vazhdimësi, krejtësisht, malësor, pakësim, etj.*

4. ë-ja e patheksuar shkruhet në të gjitha fjalët e prejardhura prej temash: -ër, -ërr, -ël, -ës, -ëz, etj.: *varfëri, zemërim, numëror, mjeshtëri, emërore, urdhërore, mbretëreshë, femërore, èndërroj, zvogëloj, rrobaqepësi, njerëzor, qumështor, etj.*

Ushtrime

1. Nënviso me **të kuqe** fjalët që janë shkruar drejt sipas rregullave të mësipërme:

gërryej	-	grryej	përrallë	-	prrallë
knetë	-	kënetë	shëtit	-	shetit
anëtar	-	antar	sistemësi	-	sistemsi
dhjetëfishoj	-	dhjetfishoj	pjestoj	-	pjesëtoj
i mirëfillët	-	i mirëfilltë	amtar	-	amëtar
armiqësi	-	armiqsi	fajsi	-	fajësi
krejtsisht	-	krejtësisht	gjyqtar	-	gjyqëtar
numror	-	numëror	zemërim	-	zemrim

Kur nuk shkruhet ë-ja e patheksuar?

1. Nuk shkruhet ë-ja e patheksuar te përemrat e pakufishëm, te ndajfoljet e te lidhëzat që kanë në përbërjen e tyre fjalët **gjithë** e **kurre**: *gjithçka, gjithkund, kurrkund, gjithsecili, kurrgjë, kurrfarë* etj.
2. Nuk shkruhet ë-ja e patheksuar te fjalët e prejardhura që përfundojnë në bashkëtingëllore me **-tar (e), -tor (e), -or, -toj**: *tregtar, shkaktar, fajtor, mishtore, kujdestar, caktoj, arsimor, shqiptoj, shpeshtoj, shqiptar, shtegtar, tregimtar* etj.

Detyrë

Shkruani një ese me dhjetë fjali me temën *Çka më pëlqen të shoqja/shoku im* dhe diskutoni me mësuesin/en nëse keni përdorur me vend zanoren **ë!**

SHKRIMI I Ë-SË NË FUND TË FJALËS

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe jep disa rregulla për shkrimin e ë-së fundore. Ato janë:

1. Shkruhen me **ë** në fund emrat femërорë si këta: *nënë, klasë, mollë, furrë, zhurmë, shkumë, valë*, etj. Po kështu shkruhen me **ë** në fund edhe emrat mashkullorë të tipit: *babë, dajë, ballë, gjumë, lumë, kalë, Lekë, toskë, gegë* etj.
2. Shkruhen me **ë** në fund mbiemrat dhe ndajfoljet si këto: *i gjatë – gjatë, i mirë – mirë, i butë – butë, i lehtë-lehtë, i gjallë – gjallë, i vonë – vonë* etj. Por, te një grup fjalësh të tjera mbiemrat shkruhen me **ë** në fund, kurse ndajfoljet jo: *i fortë – fort, i lartë – lart, i kotë – kot, plotë – plot, i thjeshtë – thjesht, i shpejtë – shpejt, i mrapshëtë – mbrasht* etj.
3. Shkruhen me **ë** në fund mbiemrat që përfundojnë me prapashtesën **-të**: *i gurtë, i artë, i drunjtë, i leshtë, i blertë, i zjarrtë*, etj.
4. Shkruhen me **ë** në fund emrat e mbiemrat mashkullorë **në shumës**: *shqiptarë, amerikanë, përtacë, shkrimitarë, studentë, sportistë, gjumashë, èndërrimtarë, punëtorë, piktorë, artistë, pejanë, shkodranë, veshë*, etj.
5. Shkruhen me **ë** në fund trajtat e emërores dhe të kallëzores së shquar të emrave mashkullorë në shumës: *të rinjtë* (të rinj), *bijtë*, (bij), *thonjtë* (thonj), *ftonjtë*, (ftonj), *të mëdhenjtë* (të mëdhenj), *miqtë* (miq) etj.

Ushtrime

1. Nënivizioni me **të kuqe** fjalët që janë shkruar drejt sipas rregullave më sipër:

pikë - pik gazet - gazetë poem - poemë rrugë - rrug
këng - këngë armiqt - armiqtë i lëkurt - i lëkurtë bijtë - bijt
djalë - djal rrymë - rrym i ftohtë - i ftoht drejt - drejtë
i shkret - i shkretë or - orë ligsh - ligstë mir - mirë

(disa) grek - **grekë** (disa) turistë - turist (disa) aeroplan - aeroplanë
(disa) lezhjanë - lezhjan (disa) përtac - përtacë (disa) dardhë - dardh
(disa) kompjuterë - kompjuter (disa) gjermanë – gjerman (disa) këng - këngë

2. Lexoni tekstin në vijim dhe gjeni fjalët e shkruara gabim, me pas shkruani në fletoret tuaja format e drejta!

Na ishte se ç'na ishte një **her** një djali jetimë që ia thoshin emrrin Kol. Përveç nënës plak në shtëpi, Kola ishte njeri pa njeri në këtë bot dhe i varfër sa s'bëhej.

Një dit djali u ngrit më natë, shtiu në strajc një çerep buk, ca kokrra qep e një calik me gjiz dhe u nis e mori rrugën e kurbetit. Në brezë kishte ngjeshur një pall të gjat e të ndryshkur që ia kishte pasë lënë i ati, por që Kolës s'i qe dhënë rasti ta vinte në pun e ta dëftente veten.

Të tretën dit, Kolës i ra udha përmidis një pylli të madh...

- Për ku je nisur, mor djali?

SHKRIMI I NYJËS SË PËRPARME

Po rikujtojmë!

Nyat e përparme në gjuhën shqipe janë: **i, e, të, së**, të cilat u paravihen emrave, mbiemrave dhe përemrave.

Mësojmë!

1. Nyat e përparme te **emrat** përdoren në këto raste:

- para emrave që tregojnë **përkatësi** a **marrëdhënie familjare** e **farefisnie**: *i ati, e ëma, e bija, i biri, i nipi, e mbesa, e shoqja, i shoqi, i vjehrri, i zoti, e zonja* etj.
- para emrave që tregojnë **ditët e javës**: *e hënë, e martë, e mërkurë, ...* etj.
- para emrave prejfoljorë e mbiemrave asnjanës: *të mësuarit, të ushtruarit, të folurit, të kuqtë, të keqtë, të verdhët* etj.
- para **emrave në rasën gjinore**, njëjës e shumës, trajta e shquar dhe e pashquar: **(i, e, të)** *djalit, vajzës, një djali, një vajze, (i, e, të) djemve, vajzave, disa djemve, disa vajzave* etj.

Mbani në mend!

Te emrat që përdoren me nyjë edhe në emërore, në gjinoren përdoren të dyja nyat **të** e **së**: te **emrat mashkullorë** **të**: (i, e) **të** *birit, të vëllait, të kunatit, të vjehrrit, etj.*, kurse te **emrat femërorë** **së**: (i, e) **së** *bijës, së motrës, së èmës, së vjehrrës* etj.

2. Nyat e përparme te **mbiemrat** përdoren në këto raste:

- para **mbiemrave të nyjshëm**: **(i, e të)** *shpejtë, mirë, fortë, zellshëm, lehtë*, etj.
- para **mbiemrave foljorë**: **(i, e të)** *myllur, shqetësuar, punuar, blerë, thyer*, etj.
- para disa **përemrave pronorë**, **dëftorë**, **lidhorë** dhe **të pacaktuar**: **(i, e, të)** *tij, saj, tyre, mi, tua, etj.; (i, e, të) tillë, tillë, etj. ; (i, e, të) cili, cila, cilët, etj.; (i, e, të) gjithë, gjitha, të tërë*, etj.

3. Nyat e përparme përdoren edhe te **numërorët**: të dy, të tre, të shtata, etj.

Ushtrojmë !

Përdorni drejt nyat **së** dhe **të** në fjalitë në vijim:

I thashë ... vëllait të saj.

Ajo fletore është e ... motrës.

Mora informata prej ... voglës së dajës.
E njoftova me lajmin më ... madhin e shtëpisë.
I vunë kurorën më ... bukurës.
Orari i ... mërkurës na përgjigjet më së shumti.
Nxënësit e ... tetës A janë më të mirët.
Parashikimi i ... ardhmes nuk është i lehtë.
Në orët e para të ... dielës ata erdhën të gjithë.
Kur i tha ... bijës se nuk do të vinte, ajo u brengos së tepërmë.
Të gjitha ia tha në sy ... ëmës ... Lules.
Shfaqjet e ... dielës u mbajtën paradite.



Shefkije Islamaj, Nexhmije Thaçi–Mehmetaj

GJUHA SHQIPE

Përbledhja e gramatikës shqipe

Fletore tematike - për nivelin e tretë

Botimi i parë

Botues:

Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:

Agim Lluka

Redaktor teknik:

Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje

Formati: 205x285

U shtyp në shkurt 2013

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

811.18:37 (076.1)

Islamaj, Shefkije

Gjuha shqipe: përbledhje gramatikës shqipe: fletore tematike

për nivelin e tretë / Shefkije Islamaj, Nexhmije Thaçi - Mehmetaj.

- Botimi i parë. - Pejë: Dukagjini, 2013. - 92 f.: ilustr. me ngjyra; 29 cm.

1. Thaçi -Mehmetaj, Nexhmije

ISBN 978-9951-05-261-0

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 2-3774, të datës 17.10.2012*